

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5990
E premte, 31 janar 2020
çmimi 0.40 €

IKShPK-ja dhe policia japin rekomandime për parandalimin e aksidenteve në trafik

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SOT (E PREMTE) MBLIDHET KRYESIA E KUVENDIT TË KOSOVËS | FAQE 4-5

KURTI KËRKON CAKTIMIN E SEANCËS PËR VOTIMIN E QEVERISË



Me kërkesë të kandidatit për kryeministër, Albin Kurti, kryesia e Kuvendit sot (e premte) do të mblidhet për ta caktuar kohën e mbajtjes së seancës plenare të Kuvendit për votimin e qeverisë së re. Kërkesën për thirrje të seancës Kurti e ka bërë pa marrëveshje me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Deri më tani Kurti për formimin e qeverisë ka marrë vetëm mbështetjen e Listës Serbe dhe të minoriteteve të tjera joshumicë

OPINION

R2- SFERA E FUSHËS MAGNETIKE, PRIMARE E TOKËS F. 11

Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan



TË FORMOHET QEVERIA E KOSOVËS DHE TË ULEN TENSIONET DUKE ELIMINUAR FJALORIN FYES DHE TË DHUNSHËM! F. 6

KMDLNJ

AKTUALE

KRYETARI I SKENDERAJT PREZANTON TË ARRITURAT E KOMUNËS PËR VITIN 2019 F. 6

KONFISKIMI I PASURISË SË PALIGJSHME, ÇELËS PËR LUFTIMIN E KRIMIT DHE KORRUPSIONIT F. 7

EKONOMI

KOSOVA ANËTARËSOHET NË KOMITETIN NDËRKOMBËTAR PËR REGJISTRIMIN E KAFSHËVE F. 9

GAP-i: SHKALLA E PUNËSIMIT TË GRAVE NË POZITA TË LARTA UDHËHEQËSE MBETET SHUMË E ULËT F. 8



KULTURË

VII. NË MBROJTJE TË ALBANOLOGJISË F. 14

Prof. asoc. dr. Myrvete Dreshaj-BALIU
Prof. dr. Begzad BALIU

PËRFAQËSUESI I LARTË I BASHKIMIT EVROPIAN PËR POLITIKË TË JASHTME DHE SIGURI, JOSEP BORRELL, KA VIZITUAR KOSOVËN

BORRELLI: BE-ja NUK PO BËN GARË ME SHBA-NË NË LIDHJE ME DIALOGUN



Përfaqësuesi i lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka bërë me dije se BE-ja nuk është në garë me ShBA-në për dialogun Kosovë - Serbi. Gjatë vizitës së parë në Kosovë ai ka thënë se BE-ja dhe ShBA-ja duan të punojnë së bashku pa dallime në këtë proces. Presidenti Hashim

Thaçi dhe përfaqësuesit e subjekteve politike në takimin me kryediplomatën evropian kanë shprehur zhgënjimet e Kosovës karshi BE-së në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave, kurse lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka refuzuar të marrë pjesë në takimin me shefin e diplomacisë evropiane | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

WE

Women in Energy

Gratë në Energji
Programi i Punës Praktike

Për të gjitha detajet:
[millenniumkosovo.org/
womeninenergy](http://millenniumkosovo.org/womeninenergy)

Thirrje për shprehje të interesit nga institucione dhe organizata të ndryshme në sektorin e energjisë në Kosovë, për angazhim të praktikanteve në punë, paguar nga MFK.

Në kuadër të projektit "Gratë në Energji - Women in Energy", të lansuar nga Fondacioni i Mijëvjeçarit i Kosovës (MFK), së shpejti do të fillojë zbatimi i programit "**Punë praktike për gra në sektorin e energjisë**" i cili ka për synim fuqizimin dhe përfshirjen e gruas në sektorin e energjisë në Kosovë.

Qëllimi i këtij programi është të mbështesë ngritjen e kapaciteteve të nevojshme profesionale të grave duke ju ofruar atyre përvojë përmes punës praktike me pagesë në institucionet publike dhe private të sektorit të energjisë në Kosovë. Paga bazike do të ofrohet nga MFK për kohë të caktuar deri në gjashtë muaj.

Përfituese të këtij programi do të jenë të gjitha gratë dhe vajzat që shprehin interesim për praktikë në punë në sektorin e energjisë e të cilat janë në vitin e fundit të studimeve Bachelor, studentet e nivelit Master, si dhe ato që kanë diplomuar në tri vitet e fundit por që nuk kanë pasur mundësi të punojnë në profesionet e tyre. Profili i vajzave aplikante do të përfshijë jo vetëm ato që i përkasin fushave STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë), por edhe disiplina të tjera të rëndësishme për sektorin e energjisë, të tilla si menaxhimi i projektit, marketingu dhe financat, ekonomia, legjislacioni, politikë-bërje, teknologjia e informacionit si dhe profile të tjera të nevojshme në këtë sektor.

Andaj, ju bëjmë thirrje të gjitha **institucioneve në sektorin publik dhe privat, organizatave joqeveritare si dhe organizatave ndërkombëtare** të angazhuara në sektorin e energjisë në Kosovë, që kanë nevojë për kontributin e profesionisteve të reja si dhe shprehin interesim për të bashkëpunuar në këtë program të aplikojnë në web faqen tonë:

millenniumkosovo.org/womeninenergy



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**



MILLENNIUM
CHALLENGE CORPORATION
UNITED STATES OF AMERICA

Gratë në Energji / Programi i Punës Praktike

Rama tërhiqet nga votimi i ligjeve kundër medias

TIRANË, 30 JANAR - Partia Socialiste ka hequr të enjten nga votimi në seancën e Kuvendit dekretin e presidentit Ilir Meta, për kthimin e ligjeve të medias.


Vendimi është njoftuar nga kreu i grupit të deputetëve të PS-së, Taulant Balla. Numri dy i PS-së tha se dekretet e presidentit do të votohen në një moment të dytë. Balla u shpreh se Partia Socialiste do të presë opinionin e Komisionit të Venecias për dy ligjet.

Këshilli i Evropës kritikoi ligjet e qeverisë "Rama", të cilat cenojnë lirinë e medias dhe kërkoi nga Komisioni i Venecias të

bënte një interpretim ligjor për paketën e njohur me emrin "Anti-shpifje".

"Edhe pas miratimit të paketës 'Anti-shpifje' ne kemi komunikuar me partnerë të rëndësishëm të Shqipërisë. Ne jemi anëtarë prej vitesh në Këshillin e Evropës. Dua të ndaj me ju se me reporterët, kemi qenë në komunikim të vazhdueshme për disa çështje dhe kemi vendosur që të kërkohet një opinion më i thelluar nga institucioni që ne shqiptarët e kemi gjithëpranuar, jo vetëm ne, sikur se është Komisioni i Venecias. Dua t'ju informoj se sapo më ka ardhur komunikim

nga Komisioni i Venecias. Komisioni i Venecias ka pranuar që ta shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar në sesionin e 21 marsit. Gjatë muajit shkurt përfaqësues të Komisionit të Venecias do të vinë në Tiranë për të dialoguar me ne, me këdo. Votimi i dekretit për mediat audiovizuale, diskutimi për të, të shtyhet, deri sa Komisioni i Venecias të na sjellë raportin e vet, më 20-21 mars", tha Balla. Ligjet u miratuan nga PS-ja në fund të muajit dhjetor dhe u kundërshtuan ashpër nga shoqatat e medieve në Tiranë dhe organizatat ndërkombëtare të gazetarëve.



Kritikat nuk kanë munguar dhe nga Zyra e OSBE-së për lirinë e medias në Vjenë, si dhe deputetët të Parlamentit Evropian.

Presidenti Ilir Meta nuk i dekretoi dy ligjet e qeverisë "Rama" me argumentin se cenojnë parimet kushtetuese dhe parimet ndërkombëtare të lirisë së fjalës.

Ruçi: Mbijetesa e Shqipërisë e lidhur me ShBA-në

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi në takim me ambasadorën e re të ShBA-së në Tiranë, Yuri Kim tha se pa ShBA-në nuk do të kishte Shqipëri në NATO, nuk do të kishte reforma të suksesshme si dhe nuk do të kishte Kosovë të pavarur

TIRANË, 30 JANAR - Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi ka pritur në një takim ambasadorën e re të ShBA-së në Tiranë, Yuri Kim. Ruçi ka thënë se falë ShBA-së, Shqipëria sot ka përfituar shumë dhe jo vetëm ka mbijetuar duke i mbajtur gjallë frymën e lirisë për shqiptarët. Pa ShBA-në nuk do të kishte Shqipëri në NATO, nuk do të kishte reforma të suksesshme si dhe nuk do të kishte Kosovë të pavarur, tha Ruçi. Po ashtu ai tha se ShBA-ja po ndihmon në nxitjen e integritimit evropian të Shqipërisë.

Kryetari i Kuvendit vuri në dukje miqësinë e fortë që lidh popujt dhe vendet tona dhe nënvizoi se "Kjo miqësi i ka rrënjët në mbrojtjen prej Shteteve të Bashkuara të fateve, integritetit dhe pavarësisë së Shqipërisë në momentet kyçe të historisë së vendit". Sipas Ruçit, mbijetesa e

Shqipërisë është e lidhur pazgjidhshmërisht me mbështetjen dhe kontributin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. 100 vjetori i parlamentarizmit shqiptar që po festojmë këto ditë është një rast për të kujtuar shpëtimin nga ShBA-ja dhe presidenti Ëillson të Shqipërisë prej copëtimit para një shekulli. Ruçi përmendi kontributin e madh të kampionit të demokracisë për të mbajtur gjallë frymën e lirisë të shqiptarët, mbështetjen e Shqipërisë gjatë transicionit demokratik, kontributin unikal të ShBA-së në pavarësinë e Kosovës, mbështetjen e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, mbështetjen e integritimit evropian të vendit si edhe për kryerjen e reformave të rëndësishme për fuqizimin e sistemit demokratik, zhvillimin e vendit dhe rritjen e mirëqenies së popullsisë.



Kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi vuri në dukje edhe kontributin e pazëvendësueshëm të ShBA-së për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon si edhe për nxitjen e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë.

Ambasadorja Yuri Kim, të enjten ka vizituar edhe Prokurorinë e Posaçme, ku është takuar me prokurorët, që do të hetojnë krimin dhe korrupsionin në nivele të larta. Përmes një mesazhi në faqen e "Facebook", ambasada

amerikane në Tiranë thekson se takimi i sotëm i ambasadores Kim dhe prokurorët e SPAK "ofroi një mundësi të shkëlqyer për të shkëmbyer pikëpamjet mbi ndihmën e vazhdueshme të ShBA-së".

Basha: Ekonomia në kolaps, vetëm biznesi i Ramës me oligarkët është fuqizuar

Tiranë, 30 janar - Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha i është përgjigjur të enjten kryeministrit Edi Rama, pas deklaratave të këtij sa i takon sektorit të ekonomisë në

Forumit Ekonomik të Tiranës. Përmes një postimi në "Twitter" Basha thekson se i vetmi që është fuqizuar, është biznesi i tij persona me të inkriminuarit dhe oligarkët.

Teksa qëndron në linjën e akuzave lideri demokrat shton se çdo biznes tjetër është nëpërkëmbur. "Edi Rama ka fuqizuar vetëm një biznes në Shqipëri. Biznesin e tij personal

me të inkriminuar dhe oligarkë. Çdo biznes tjetër në Shqipëri është nëpërkëmbur dhe goditur nga qeverisja e Edi Ramës në shërbim ndaj oligarkëve të tij", ka shkruar Basha.



Sot (e premte) mblidhet kryesia e Kuvendit të Kosovës

Kurti kërkon caktimin e seancës për votimin e qeverisë

Me kërkesë të kandidatit për kryeministër, Albin Kurti, kryesia e Kuvendit sot (e premte) do të mblidhet për ta caktuar kohën e mbajtjes së seancës plenare të Kuvendit për votimin e qeverisë së re. Kërkesën për thirrje të seancës Kurti e ka bërë pa marrëveshje me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Deri më tani Kurti për formimin e qeverisë ka marrë vetëm mbështetjen e Listës Serbe dhe të minoriteteve të tjera joshumicë



**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 30 JANAR - I nominuari për kryeministër, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka kërkuar të enjten nga kryesia e Kuvendit që ta caktojë kohën e mbajtjes së seancës parlamentare për votimin e përbërjes së qeverisë së re. Për caktimin e kohës së mbajtjes së kësaj seance, kryesia e Kuvendit sot (e premte) do të mblidhet në orën 09:00. “Kërkesa e kandidatit për kryeministër, z. Albin Kurti, për thirrjen e seancës plenare të Kuvendit për votimin e përbërjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës”, është thënë në njoftimin për media të Zyrës për Informim të Kuvendit. Këtë veprim Kurti e ka bërë pa marrëveshje me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Të premten ai nuk ka bërë ndonjë përpjekje për t’u takuar me zyrtarët e kësaj partie. Megjithatë, LDK-ja edhe një herë ka shprehur gatishmërinë

për koalicionin me LV-në, nëse kjo e fundit ia plotëson kushtet.

Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje si fituese e zgjedhjeve të 6 tetorit duhet ta shfrytëzojë mundësinë e formimit të qeverisë. “Qeveria mund të bëhet sepse kemi arritur shumë afër, por presim që partia që ka dalë e parë ta pranojë zgjidhjen që ne e kemi ofruar, që e konsiderojmë zgjidhje të balancuar. Nuk shohim asnjë arsye që të hyjmë në një kënd që nuk e njohim formimin e institucioneve” ka thënë Mustafa.

Ai ka treguar se nëse do të bëhej koalicioni me LV-në, LDK-ja do të përkushtohet maksimalisht për përmbushjen e detyrave qeverisëse. “Takime nuk kemi pasur të veçanta, përpos sot në takimin me Josep Borrellin. Nuk kemi biseduar për këtë. Nuk kam arsye të insistoj te Kurti se a po pajtohet ose jo, sepse Vetëvendosje është parti që e konsiderojmë më serioze dhe që i merr vendimet vetë”, është

shprehur Mustafa.

Ndonëse nuk i takoi përfaqësuesit e LDK-së, Kurti të enjten ka takuar përfaqësuesit e Listës Serbe dhe ata të minoriteteve të tjera. Këta të fundit kanë bërë me dije se nuk do të jetë frenues të formimit të Qeverisë së Kosovës.

Pas takimit me Kurtin, kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiq, ka theksuar se u takon partive të shumicës shqiptare që ta sigurojnë shumicën në Kuvend, por në çdo rast ai ka thënë se “nuk do të jenë frenues” të formimit të qeverisë së re. “Atë që dua ta them dhe që është fakt, për që janë të vetëdijshëm bashkësia ndërkombëtare dhe

Prishtina, është se pa Listën Serbe si një subjekt i rëndësishëm politik nuk mund të formohet qeveria”, ka deklaruar Rakiq. Ai ka deklaruar se Lista Serbe do ta ketë përfaqësuesin e vet në Qeverinë e re të Kosovës.

Kurti gjatë ditës së enjte është takuar edhe me deputetët e tjerë të minoriteteve. Veton Berisha, deputet nga Partia Liberale Egjiptiane (PLE), ka treguar kërkesat e tij ndaj mandatarit për formimin e qeverisë së re. “Me kërkesë të Albin Kurtit unë Hetem Arifi dhe Duda Balje kemi zhvilluar takim me z. Kurti. Ishte kërkesë e Kurtit për ta mbështetur atë në formimin e

qeverisë. Patëm një takim në vazhden e takimeve që kemi pasur më herët”, ka thënë ai, duke shtuar se në qeverinë e re duan ta kenë një ministri. “Kërkesë e jona është që të ketë ndryshime, pasi komuniteti rom-egjiptian ka qenë i anashkaluar dhe kërkesa jonë është që të udhëheqim një ministri dhe po presim që ta shqyrtojë këtë kërkesë. Kjo varet nga marrëveshja me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjen Vetëvendosje”, ka deklaruar.

Liderit të LV-së, Albin Kurti, i kanë mbetur edhe katër ditë për t’ia propozuar për votim Kuvendit kabinetin qeverisë.

IKShPK-ja dhe policia japin rekomandime për parandalimin e aksidenteve në trafik

PRISHTINË, 30 JANAR (ER) - Në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) të enjten është mbajtur takimi i përbashkët me përgjegjësitë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës lidhur me sigurinë në trafikun rrugor dhe numrin e lartë të aksidenteve në trafik. “Siguria rrugore është një çështje shumë e rëndësishme dhe Kosova ka pasur rritje të konsiderueshme të numrit të vdekjeve në trafik në dekadën e fundit, po ashtu edhe numri i këmbësorëve të vdekur në aksidente rrugore është shumë i lartë. Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, Kosova në vitin e kaluar (2019) në aksidentet në trafik ka pasur 113 persona të vdekur, ndërsa në vitin paraprak (2018) gjithsej 129

persona të vdekur në aksidentet me fatalitet në trafik”, është theksuar në njoftimin për media të IKShPK-së.

Në takim u konstatua se shkaqet e aksidenteve në trafik janë të shumta dhe të ndryshme, por sigurisht faktori njeri mbetet më i shpeshtë pasi që nuk janë duke u respektuar rregullat e përgjithshme në trafik, respektivisht masat që ndërlihen me shpejtësinë, përdorimin e rripave të sigurisë dhe ulëseve për fëmijë; përdorimin e alkoolit, drogave dhe medikamenteve; mbajtjen e distancës së sigurisë, si dhe gjendjen e automjeteve dhe kohën e ngasjes dhe pushimit për shoferë. “IKShPK dhe Policia e Kosovës theksojnë se zhvillimi i një ‘kulture të sigurisë rrugore’ është shumë me rëndësi, prandaj



duhet ngritur edhe më tej vetëdijësimin e popullatës për rreziqet dhe përgjegjësinë e tyre në trafik, si dhe duhet të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme nga institucionet përgjegjëse për zvogëlimin dhe parandalimin e

aksidenteve në trafik”, është thënë në këtë njoftim.

IKShPK dhe Policia e Kosovës me këtë rast kanë përsëritur edhe disa prej rekomandimeve me qëllim të parandalimit të aksidenteve në trafikun rrugor: 1.

Qytetarët duhet t’i respektojnë të gjitha rregullat në trafikun rrugor; 2. Shoferët duhet të jenë të përqendruar maksimalisht gjatë drejtimit të automjetit; 3. Shoferët duhet ta respektojnë shpejtësinë e lejuar; 4. Shoferët duhet të mos i përdorin telefonat mobilë gjatë vozitjes; 5. Shoferët me dënime të njëjta të përsëritura duhet të detyrohen t’u nënshtrohen testeve psikologjike dhe për ta nevojiten masa më të rrepta sanksionuese dhe masa shtesë për përmirësimin e ngasjes së tyre; 6. Lëshimi i certifikatës mjekësore për patentë shofer duhet të bëhet duke respektuar kriteret në mënyrë rigorozë; 7. Këmbësorët si pjesëmarrës në trafik janë të obliguar t’i respektojnë rregullat e trafikut njësoj sikur edhe pjesëtarët e tjerë në trafik.



Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka vizituar Kosovën

Borrelli: BE-ja nuk po bën garë me ShBA-në në lidhje me dialogun

Përfaqësuesi i lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka bërë me dije se BE-ja nuk është në garë me ShBA-në për dialogun Kosovë - Serbi. Gjatë vizitës së parë në Kosovë ai ka thënë se BE-ja dhe ShBA-ja duan të punojnë së bashku pa dallime në këtë proces. Presidenti Hashim Thaçi dhe përfaqësuesit e subjekteve politike në takimin me kryediplomatit evropian kanë shprehur zhgënjimet e Kosovës karshi BE-së në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave, kurse lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka refuzuar të marrë pjesë në takimin me shefin e diplomacisë evropiane

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 30 JANAR - Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka deklaruar se BE-ja nuk është në garë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) në lidhje me lehtësimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pas takimit me presidentin e vendit, Hashim Thaçi, zyrtari i lartë i BE-së ka deklaruar se Bashkimi Evropian është i përkushtuar që ta lehtësojë arritjen e marrëveshjes në mes të

Kosovës dhe Serbisë. “Ne jemi këtu që ta lehtësojmë marrëveshjen në mes të Serbisë dhe Kosovës. Të njëjtën gjë po e bën edhe z. Grenell. Unë nuk po shoh se ka dallim. Ne nuk po bëjmë gara me njëri-tjetrin. Ne duam të punojmë së bashku pa dallime. Nuk po kërkojmë që të arrijmë patjetër sukses, por po kërkojmë që të jemi aty, ta bëjmë shërbimin tonë dhe të arrijmë një rezultat”, ka thënë Borrell.

Ai ka bërë me dije se do të punojë bashkë me amerikanët për të arritur një marrëveshje. “Amerikanët kanë shumë plane. Për Lindjen e Mesme, Korenë dhe

për këtu. Është një çështje të kesh plan dhe çështje tjetër të angazhohesh për të pasur sukses. Ne kemi investuar më shumë se 1 miliard. Nuk po bëjmë garë me amerikanët. Do të punojmë së bashku dhe nuk do të ketë ndasi. Ne nuk jemi këtu t'i vëmë fajin njëri-tjetrit. Ne ndoshta nuk jemi mjaft të zëshëm, por jemi mjaft të përfshirë në këtë çështje”, ka thënë Borrell.

Shefi i diplomacisë evropiane ka deklaruar se Bashkimi Evropian nuk do të duket i kompletuar pa përfshirjen e Ballkanit Perëndimor. “E di dhe i shoh vuajtjet dhe problemet që ju dhe

shtetet e tjera i kanë pasur dhe ne duam të sigurojmë stabilitet dhe siguri për secilin. Nuk po e themi këtë për shkak të publikut, por sepse e mendojmë kështu. Kjo është edhe në interesin tonë, gjithashtu. Stabiliteti në rajon dhe siguria, prosperiteti dhe liria e secilit shtet në Evropë është në prioritetin tonë”, ka thënë ai. Sipas tij, Brukseli do të dëshironte që ta shohë sa më shpejt qeverinë e re të Kosovës të formuar për t'i vazhduar punët e shumta që e presin.

Sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, Borrell ka thënë se nuk mund të garantojë asgjë pasi që vendimi merret nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. “Mund të them se Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave dhe është koha e duhur që të lëvizet dhe të përfundohet me kërkesat teknike”, është shprehur ai. Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se vizita e Borrellit në Prishtinë është shumë e rëndësishme në një kohë vendimtare. “Vetë vizita e parë që Borrelli po e zhvillon në Kosovë

për të vazhduar tutje në rajon e Ballkanin Perëndimor, tregon rritjen e vëmendjes së BE-së drejt Kosovës dhe Ballkanit në përgjithësi. Në një moment vendimtar për të ardhmen e vendit tonë, integrimet euroatlantike për zhvillimin ekonomik, anëtarësimin në NATO e BE”, ka deklaruar Thaçi. Ai ka treguar se në emër të institucioneve të Kosovës i ka shprehur shefit të diplomacisë evropiane, Josep Borrell, edhe zhgënjimin për mungesën e vendimit të Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. “Kosova është padrejtësisht e anashkaluar, pasi Kosova ka plotësuar të gjitha kriteret që nevojiten për liberalizim të vizave”, ka thënë Thaçi.

Lidhur me dialogun Kosovë - Serbi, Thaçi ka deklaruar se marrëveshja përfundimtare në mes të dy vendeve është jetike për paqen dhe stabilitetin në rajonin dhe më gjerë. “Pra, çelës i arritjes së marrëveshjes është integrimi evropian dhe koordinimi i ngushtë në mes të BE-së dhe

ShBA-së. Natyrisht çelësi i suksesit është marrëveshja e drejtë, që nënkupton njohje reciproke dhe anëtarësim të Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara”, është shprehur shefi i shtetit.

Borrelli takon përfaqësuesit e partive politike

Gjatë vizitës së tij të parë në Kosovë, përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell, ka zhvilluar një takim të përbashkët me drejtuesit e partive parlamentare në Kuvendin e Kosovës. Në këtë takim, përfaqësuesit e subjekteve politike kanë prezantuar qëndrimet e tyre për dialogun para kryediplomatit evropian. Pas takimit, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se në takim i ka treguar Borrellit se dialogu Kosovë - Serbi, i lehtësuar nga Bashkimi Evropian, duhet të rishikohet dhe të rivlerësohet.

Në profilin e tij në “Twitter”, Kurti ka shkruar se BE-ja është një forcë e domosdoshme për të ardhmen e rajonit. “Diskutim i frytshëm sot me përfaqësuesin e BE-së, Josep Borrell, në vizitën e tij të parë në Kosovë. Unë pohova se dialogu i lehtësuar nga Bashkimi Evropian duhet të rishikohet dhe të rivlerësohet. BE-ja është një forcë për të mirë dhe mbetet e domosdoshme për të ardhmen e rajonit”, ka shkruar Kurti.

Versionin e saj para diplomatit evropian e ka dhënë edhe LDK-ja. “Njëkohësisht kryetari Mustafa e njoftoi z. Borrell për prioritetet e LDK-së, si: zhvillimin ekonomik, shtetin ligjor, rritjen e punësimit, rritjen e investimeve të huaja direkte, zhvillimin e arsimit dhe shëndetësisë etj. Po ashtu, kryetari Mustafa u bëri thirrje institucioneve të BE-së që ta përshejtojnë procesin e liberalizimit të vizave që qytetarët e Kosovës ta realizojnë të drejtën e

tyre për lëvizje të lirë”, është thënë në komunikatën për mede të LDK-së.

Kurse kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se në këtë takim është biseduar për proceset integruese dhe procesin e dialogut Kosovë - Serbi. “Ne duam një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ku përfshihet njohja. Pra, duhet të kemi një agjendë të qartë dhe të mbyllet tema Kosovë - Serbi”, ka thënë Limaj. Ai ka theksuar se nuk mund të ketë marrëveshje gjithëpërfshirëse pasi që krerët e institucioneve të Serbisë vazhdojnë t’i mohojnë krimet dhe gjenocidin e bërë në Kosovë. Kur është pyetur për formimin e qeverisë së re nëse kanë marrë sinjale nga Borrell për këtë temë, ai ka thënë se formimi i institucioneve të reja është çështje e brendshme, që u takon partive politike në Kosovë. “Diplomatët duhet t’i ushtrojnë kompetencat e tyre dhe çështja e qeverisë nuk është e tyre dhe nuk mund të ndërhyjnë. Çështja e qeverisë është ekskluzive çështje e brendshme e partive tona”, ka thënë Limaj.

Në këtë takim, AAK-ja është përfaqësuar nga sekretari i

përgjithshëm, Besnik Tahiri. Pas takimit, ai ka treguar se ka kërkuar që BE-ja sa më shpejt ta vendosë në agjendë liberalizimin e vizave. “Në takim i bëmë publike qëndrimet tona. Treguam zotimin tonë për përmbushjen e MSA-së. Kërkuam që sa më shpejt të vendoset në agjendë liberalizimi i vizave”, ka thënë Tahiri.

Ai ka folur edhe për qëndrimin e AAK-së për dialogun Kosovë - Serbi. “Sa i përket temës së dialogut, si AAK e përshëndetëm angazhimin e Merkelit, Macronit dhe Grenellit. Thamë se sa i përket dialogut është e rëndësishme që të kemi një njohje reciproke, është e vetmja zgjidhje sepse që 20 vjet e kemi humbur kohën”, ka deklaruar ai. Pas Kosovës, zyrtari i lartë evropian do të udhëtojë për në Serbi, ku edhe atje do t’i takojë përfaqësuesit e shtetit. Borrell pritet ta ndërmjetësojë dialogun për normalizimin e marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit. Procesi i dialogut në mes të dy vendeve është pezulluar në fund të vitit 2018, kur Kosova u ka vënë taksë 100 për qind prodhimeve të importuara nga Serbia dhe Bosnja.

Veseli refuzon takimin me Borrellin

Partia Demokratike e Kosovës ka refuzuar të marrë pjesë në takimin e paralajmëruar me përfaqësuesin e lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell.

Kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se takimi është i pakuptimtë në kushtet kur në Kosovë nuk është formuar qeveria e re. Po ashtu, ai tha se ky takim kundërshtohet edhe për faktin se Kosovës ende nuk i është dhënë liberalizimi i vizave, edhe pse janë plotësuar kriteret e kërkuara nga BE-ja. “Takimi sot është i pakuptimtë në kushtet e mosekzistencës së qeverisë dhe institucioneve të reja dhe çfarëdo iniciative për rinisje të procesit të dialogut me palën serbe, është i tejkaluar dhe i paqëndrueshëm

derisa Kosova vazhdon të jetë peng i inateve dhe paaftësisë për të bërë kompromis dhe për të gjetur zgjidhje dy forcat politike, LV dhe LDK”, ka thënë Veseli, duke përmendur edhe arsyet e tjera. “Kërkojmë që mosprania jonë të kuptohet edhe si alarm se procesi i dialogut vitet e fundit ka degraduar edhe nga mungesa e qëndrimit më proaktiv e determinues të BE-së, si ndërmjetëse e këtij procesi. Kosova ka treguar në të kaluarën përkushtimin e saj në këtë proces. PDK-ja, pas krijimit të institucioneve të reja, në bazë të Kushtetutës dhe vullnetit të qytetarëve, është gatshme të angazhohet në proces për të arritur një marrëveshje historike”, është shprehur Veseli.




ZKA: Përcaktimi i tarifave për shërbimet publike nuk është bërë plotësisht sipas kriterëve

PRISHTINË, 30 DHJETOR (ER) - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka bërë publik raportin e performancës për projektin “Sistemi i përcaktimit të tarifave të energjisë elektrike, termike dhe atyre të ujësjellësit”.

Raporti konstaton se, pavarësisht prej përparimit të arritur nga rregullatorët në procesin e përcaktimit të tarifave, ka disa mangësi që ndikojnë në saktësinë e tarifave të aprovuara dhe të cilat rrezikojnë që tarifat të mos jenë drejt të përcaktuara. “Po gjatë procesit të përcaktimit të tarifave, rregullatorët nuk kanë arritur të sigurojnë transparencë të mjaftueshme si dhe vendosje plotësisht të drejtë dhe të saktë të

tarifave”, është thënë në raportin e ZKA-së.

Raporti thekson se rregullatorët dhe ofruesit e shërbimeve publike nuk kanë zhvilluar një proces të identifikimit të sasisë së konsumuar të shërbimeve nga konsumatorët të cilët janë të liruar nga pagesa e shërbimeve publike për t’u kompensuar nga autoritetet përkatëse. “Edhe përcaktimi i kostove operative, kostove kapitale dhe koeficienteve të tjerë të rëndësishëm financiarë nuk aprovohet plotësisht bazuar në analiza përkatëse dhe të dokumentuara me sqarime të mjaftueshme dhe të qarta. Parakushtet procedurale dhe teknike gjatë procesit për



përcaktimin e tarifave nuk sigurojnë një pjesëmarrje të kënaqshme të qytetarëve dhe shoqërisë civile në aktivitetet e konsultimeve publike, qasje e cila ka rezultuar në një situatë ku

konsultimet publike - pjesëmarrja e publikut në përcaktimin e tarifave në përgjithësi është shumë e kufizuar”, është theksuar në raport.

Sipas ZKA-së, ky auditim kishte

për qëllim vlerësimin se sa efektiv është sistemi i përcaktimit të tarifave të shërbimeve publike, njëkohësisht t’i identifikojë boshllëqet dhe vlerësojë nëse procesi i përcaktimit të tarifave për shërbimet publike është bërë sipas kriterëve të matshme dhe në përputhje me shpenzimet reale dhe relevante. Zyra Kombëtare e Auditimit u rekomandon autoriteteve përgjegjëse që ta zhvillojnë tutje dhe të implementojnë drejt dhe me saktësi metodologjinë për përcaktimin e tarifave duke siguruar se konsumatorët e shërbimeve publike paguajnë tarifa të shërbimeve publike të vendosura saktë dhe drejt.

Reagim i KMDLNj-së

TË FORMOHET QEVERIA E KOSOVËS DHE TË ULEN TENSIONET DUKE ELIMINUAR FJALORIN FYES DHE TË DHUNSHËM!

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut në Prishtinë me vëmendje po e përcjellë situatën e krijuar pas zgjedhjeve të fundit në Kosovë me ç'rast fitues doli të jetë LV-ja, e dyta LDK-ja, e treta PDK-ja kurse e katërta AAK-PSD sikur që koalicioni Nisma-AKR siguroi vota të mjaftueshme për Kuvend të Kosovës. Si asnjëherë më parë, partitë jofituese, PDK-ja dhe AAK-PSD menjëherë pranuan rezultatin e zgjedhjeve, u deklaruan si opozitë e ardhshme duke ua lehtësuar në masë të madhe LV-së dhe LDK-së bërjen e koalicionit për bashkëqeverisje dhe formimin e institucioneve. Premtimet e LV-së dhe LDK-së garantanton se në afatin rekord do të arrihet marrëveshje dhe se do të formohen institucionet. Koha tregoi se këto premtime ishin në shpërputhje të madhe me gjendjen reale në raportet midis këtyre dy subjekteve politike dhe, për këtë arsye, deri më tani nuk kemi një marrëveshje të premtuar

ndonëse kanë mbetur vetëm pesë ditë deri në përfundim të afatit kushtetues për formimin e qeverisë së Kosovës nga i mandatuari për kryeministër, Albin Kurti, kryetar i LV-së. KMDLNj e ka përkrahur koalicionin LV dhe LDK, si mundësi dhe detyrim real në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të fundit.

Në rrugëtimin drejt arritjes së një marrëveshjeje për bashkëqeverisje midis LV-së dhe LDK-së nuk ka pasur asnjë pengesë, qoftë nga opozita, shoqëria civile, mediat dhe komunitetet tjera në Kosovë prandaj, për KMDLNj është e paqartë por edhe e papranueshme vonesa e arritjes së marrëveshjes si dhe formimit të institucioneve.

Realisht, kjo vonesë, mbështetur në praktikën e mëparshme në Kosovë por edhe në vendet me një demokraci shumë më të zhvilluar dhe të qëndrueshme, nuk është e madhe dhe nuk do të ishte shqetësim po të mos

ishte miratimi i buxhetit të Kosovës dhe rreziku real për një kolaps institucional dhe shtetërorë për shkak të afateve të ngushta. Edhe ambasadat e huaja në Kosovë kanë inkurajuar formimin sa më të shpejtë të qeverisë së Kosovës duke përkrahur botërisht koalicionin LV-LDK. Në takimin e fundit midis LV-së dhe LDK-së morën pjesë ambasadorët apo përfaqësuesit e vendeve të Quintit si dhe përfaqësuesja e BE-së e që u deklaruan se nuk kanë ndërhyrë te subjektet politike për formim të Qeverisë e që, për KMDLNj-ja është e papranueshme dhe paraqet ndërhyrje flagrante në punët e brendshme të një shteti që e llogarisin si sovran dhe të pavarur.

Qëndrimi paternalist i ndërkombëtarëve në takimin e fundit midis këtyre dy subjekteve politike është mohim i demokracisë përmes imponimit "konstruktiv" të formimit të qeverisë për faktin se vet prania në këtë takim është trysni që, më shumë e pengon formimin dhe konsolidimin e institucioneve, se që e ndihmon atë!

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut në Prishtinë thërret LV-në dhe LDK-në, që në kuadër të hapësirës së lejuar kushtetuese

të bëjnë përpjekje për arritjen e një marrëveshjeje që nënkupton fleksibilitet gjatë bisedimeve si dhe qëndrim konstruktiv duke e eliminuar ndjenjën apo matematikat se sa kush humbë dhe sa kush fiton. Nëse nuk arrihet kjo marrëveshje, e KMDLNj nuk sheh asnjë arsye të mos arrihet, humbësit më të mëdhenj do të jenë pikërisht këto dy subjekte politike që kanë premtuar shumë reforma apo hapa të mëdhenj për qytetarin dhe Kosovën ndërsa nuk po kanë vullnet e as kapacitet ta bëjnë një hap të vogël që iu ka mbetur, arritja e marrëveshjes për bashkëqeverisje. Alternativa tjera siç janë shkuarja në zgjedhje të reja janë shumë të dëmshme sepse nuk e ndryshojnë apo fare pak e ndryshojnë konfiguracionin politik në Kosovë. Qeveria e pakicës, mbështetur në raportin e forcave ku pozita do të ishte minoritet absolut politik kurse opozita mazhorancë dominuese do të shërbente vetëm për një përdorim; votimin e Buxhetit të Kosovës pas së cilës, kërkesa e parë për votëbesim të qeverisë do e shrinte këtë qeveri të pakicës për toke.

KMDLNj pret që marrëveshja për bashkëqeverisje të nënshkruhet sa më parë duke

pasur parasysh rezultatin e zgjedhjeve të fundit, si sa i përket përgjegjësisë së fituesit të zgjedhjeve, LV-së për formim të institucioneve ashtu edhe demonstrimit të gatishmërisë për të bërë kompromis, gjithashtu nga pozita e fituesit. Në këtë kontekst, KMDLNj pret që edhe partitë opozitare të votojnë për qeverinë në ardhje, nëse do të kemi marrëveshje, pa e kushtëzuar votën me asgjë.

KMDLNj është i shqetësuar shumë me fjalorin jodemokratik, kërcënues dhe fyes që po përdoret, si ndaj subjekteve politike, bartësve të posteve, liderëve të subjekteve politike dhe të tjerëve e që, në masë të madhe po e tensionon situatën në vend prandaj e fton Prokurorinë e Shtetit që të merret me këto dyshime të ngritura botërisht për faktin se fjala publike bartë përgjegjësi publike, morale dhe ligjore. Fjala e shprehur publikisht mund të ndihmojë hetuesinë, nëse është e mbështetur në fakte, në të kundërtën denoncuesi që në mënyrë të paargumentuar luan me personalitetin, integritetin moral, profesional, familjar dhe njerëzor, të kujtudo qoftë ai, duhet t'u nënshtrohet sanksioneve ligjore si masë parandaluese për të tjerët. Përmendja e familjarëve të papërfshirë në çfarëdo aktiviteti të kundërligjshëm, për qëllime ekskluzivisht të përfitimit politik, KMDLNj e konsideron si veprim të pandershëm dhe të dënueshëm dhe sjellje të tilla duhet të ndërpriten menjëherë. Është koha e fundit që t'i ndajmë përgjegjësitë, ato që iu takojnë organeve të drejtësisë janë për organet e drejtësisë, prandaj duhet t'u përmbahemi këtyre standardeve që janë vlera dhe detyrime të çdo shteti apo vendi demokratik!



Kryetari i Skenderajt prezanton të arriturat e komunës për vitin 2019

SKENDERAJ, 30 JANAR (ER) - Të enjten është mbajtur seanca e Kuvendit Komunal të Skenderajt, e para për këtë vit, në të cilën kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka prezantuar punën e ekzekutivit për vitin 2019.

Kryetari Jashari ka përmendur buxhetin e komunës për vitin 2019, i cili, sipas tij, ka qenë 14.7 milionë euro, kurse është realizuar 92 për qind. Ai ka thënë se komuna që ai drejton ka bërë shkurtim të shpenzimeve në kategorinë e pagave si rezultat i heqjes së mëditjeve për udhëtimet zyrtare. "Si rezultat i angazhimit tonë në rritjen e inkasimit kemi tejkaluar planin e të hyrave me rreth 800 mijë euro më shumë. Inkasimi nga tatimi në pronë në vitin 2019

është rritur me 22 për qind në krahasim me vitin 2018. Kemi publikuar kontratat e prokurimit të nënshkruara nga Komuna e Skenderajt me të gjithë operatorët ekonomikë. Gjatë vitit 2019 kemi rritur efikasitetin e zbatimit të ligjit përmes fuqizimit të inspektorati, duke ndërmarrë aksione të rrënimit të ndërtimeve pa leje, konfiskimin e produkteve ushqimore me afat të skaduar si dhe aplikimin e gjobave mandatore për ndotësit e mjedisit", ka deklaruar Jashari.

Kryetari Bekim Jashari ka folur rreth projekteve kapitale të cilat janë realizuar në infrastrukturë rrugore, shkolla, spitale, ujësjellës, kanalizim, mjedis etj., si dhe rreth projekteve që tashmë kanë filluar së realizuari si: Ndërtimi i

parkut të biznesit, inkubatori i biznesit, poligoni multifunksional etj. "Që nga fillimi i mandatit tim prioritet të veçantë i kam dhënë zhvillimit të bujqësisë, përkrahjes së fermerëve duke rritur buxhetin për bujqësinë. Në vitin 2019 së bashku me donatorët dhe participimin e fermerëve buxheti për bujqësinë ka qenë 158 mijë euro, ku janë mbështetur 191 fermerë", ka thënë Jashari. Ai ka folur dhe për angazhimin e komunës në eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave, shtimin e zonave të gjelbra në qytetin e Skenderajt, duke mbjellë më shumë se 755 drunj dekorativë në qytet si dhe duke rritur nivelin e menaxhimit të mbeturinave.

Në këtë seancë është miratuar



propozim-vendimi për dhënie në diskutim publik të draftregullores për dhënie në shfrytëzime deri në një (1) vit të pronës, objekteve, lokaleve dhe hapësirave publike në komunën e Skenderajt, propozimvendimi për shqyrtimin publik të projek-

tit "Harta Zonale e Komunës së Skenderajt 2020-2028, propozimvendimi për shpalljen e zonave me interes publik në Komunën e Skenderajt si dhe plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020.

Konfiskimi i pasurisë së paligjshme, çelës për luftimin e krimit dhe korrupsionit

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 JANAR - Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ka prezantuar të enjten raportin "Mbështetja e mëtejshme e institucioneve të Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm". Me këtë rast u tha se konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të jashtëligjshme është çelësi për luftimin e krimit dhe korrupsionit.

Kryetari për sundim të ligjit në BE, Cezary Michalczuk, ka deklaruar se Kosova ka një legjislacion të mirë sa i përket konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të jashtëligjshme dhe, sipas tij, tash mbetet të shihen rezultatet konkrete. "Ne kemi diskutuar për konfiskimin, ka mbetur një kornizë shumë e mirë për luftimin e këtyre veprave. Ato që priten janë konkrete, rezultate konkrete, pra konfiskim", ka thënë ai.

Edhe udhëheqësi i projektit Ian McDonald ka deklaruar se Kosova ka legjislacion të fuqishëm sa i përket konfiskimit. "Pasi dikush është dënues për një krim të organizuar, pritet t'i shpjegojë



gjykatës nga ka ardhur e gjithë pasuria e tij. Korniza ligjore që ka Kosova është më e fuqishme dhe më e lehta për t'u vënë në funksionim", ka thënë McDonald.

Në këtë prezantim të këtij raporti ka marrë pjesë edhe kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, i cili ka thënë se ky projekt, por edhe projektet e tjera, janë të një rëndësi të veçantë, sepse kanë për qëllim përmirësimin e sistemit të drejtësisë. "Në këtë

drejtim jemi duke punuar së bashku me partnerët ndërkombëtarë në forcimin e sundimit të ligjit, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe vlerave të demokracisë", ka thënë ai.

Me këtë rast, kryeprokurori Lumezi ka falënderuar bartësit e këtij projekti për punën profesionale dhe kontributin e dhënë në plotësim-ndryshimin e Kodit Penal, atij të Procedurës Penale dhe Ligjit mbi kompetencat e zgjeruara të

konfiskimit të pasurisë së përfitur me veprë penale, duke bërë kështu që tashmë në duart e prokurorëve të jenë instrumente të cilat e lehtësojnë luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe veprave të tjera të rënda penale. Po ashtu, kryeprokurori i Shtetit ka folur edhe për konfiskimin e pasurisë, me ç'rast ka deklaruar se të kaluarën nuk ka pasur rezultate të prekshme në sferën e

sekustrimit dhe konfiskimit dhe në këtë drejtim, "vetëm atëherë kur të bëhet konfiskimi i pasurisë dhe marrja e pushtetit ekonomik nga duart e grupeve kriminale, e dimë që jemi në rrugën e duhur sepse çelësi i suksesit në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe terrorizmit qëndron në konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme", ka deklaruar kryeprokurori Lumezi.

Kërkohet revokimi i masës së përkohshme për pezullimin e Ligjit të pagave



PRISHTINË, 30 JANAR (ER) - Pas takimit me Avokatin e popullit, SBASHK-u, Sindikata e Shëndetësisë, e Policisë, e Doganës dhe ajo e Zjarrfikësve kanë vazhduar takimet e përbashkëta konsultative me qëllim që të ndërmarrin angazhime të përbashkëta dhe kanë përgatitur kërkesën e përbashkët, të cilën e kanë dorëzuar të enjten në Gjykatën Kushtetuese me kërkesën që ajo ta revokojë masën e përkohshme për pezullimin e Ligjit të pagave.

Për këtë angazhim këto pesë sindikata kanë informuar edhe Avokatin e Popullit. "Gjatë takimit me të janë të bindur se Kushtetuesja do ta marrë në shqyrtim këtë kërkesë dhe atë që Avokati i Popullit e kishte proceduar bazuar në kërkesat e institucioneve arsimore të arsimit, që ishin nënshkruar nga anëtarët e SBASHK-ut dhe ishin dorëzuar në adresën e Institucionit të Avokatit të Popullit. SBASHK, FSSHK-ja, SPK-ja, Sindikata e Doganës së Kosovës dhe ajo e Zjarrfikësve

në takimin e së enjtes, krahas aprovimit të kërkesës së përbashkët drejtuar Kushtetueses, janë pajtuar që të vazhdojnë takimet konsultative me qëllim që angazhimet të jenë të përbashkëta lidhur me Ligjin e pagave, por edhe për çështje të tjera të rëndësishme për anëtarësinë e këtyre pesë sindikatave, që përfaqësojnë të punësuarit në sektorë shumë të rëndësishëm", është thënë në komunikatën e përbashkët të këtyre pesë sindikatave.

Myftiu i Egjiptit priti në takim myftiun Tërnavë

PRISHTINË, 30 JANAR (ER) - Gjatë qëndrimit zyrtar në Egjipt kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim Tërnavë, u prit edhe nga myftiu i nderuar i Egjiptit, prof. dr. Shevki Allam, për të vendosur një nga hapat e parë të bashkëpunimit në ndërinstitucional në disa fusha me interes, në veçanti në fushën e ngritjes së kapaciteteve të kuadrit

profesional në fushën e Fikhut, gjegjësisht të fetvave.

Myftiu Tërnavë ka falënderuar myftiun Alam për mikpritjen e ngrohtë dhe ka njoftuar myftiun e Egjiptit për organizimin e jetës fetare në Kosovë dhe për institucionet fetare-arsimore të Bashkësisë Islame, si dhe ka kërkuar shqyrtimin e mundësisë së bashkëpunimit sidomos në fushën e trajnimeve të

specializuara.

Nga ana tij, myftiu i Egjiptit, prof. dr. Shevki Allam, ka falënderuar myftiun Tërnavë për vizitën dhe ka shprehur gatishmërinë e tij të plotë dhe të institucionit që drejton për ta ndihmuar BIRK-un në ofrimin e përvojës dhe mundësisë që edhe studiues nga Kosova të përfitojnë nga programet e specializuara në fushën e fetvasë.



GAP-i: Shkalla e punësimit të grave në pozita të larta udhëheqëse mbetet shumë e ulët

PRISHTINË, 30 JANAR (ER) - Instituti GAP ka publikuar raportin statistikor për vitin 2019 "Punësimi dhe përfaqësimi i grave në Kosovë". Ky raport paraqet në mënyrë statistikore pozitën e gruas në punësim, arsim dhe mirëqenie sociale. Sipas GAP-it, statistikatat për vitin 2019 tregojnë se në Kosovë vajzat dhe gratë janë të interesuara për shkollim dhe punësim po aq sa djemtë dhe burrat. Megjithatë, shkalla e punësimit të tyre, sidomos në pozita të larta udhëheqëse, mbetet shumë e ulët në krahasim me burrat. "Këto dallime janë më të shprehura sidomos në nivelin qendror. Deri në ditën e dorëheqjes së kryeministrit Haradinaj vetëm 10 për qind e posteve të larta drejtuese (ministra, zëvendësministra, sekretarë të përgjithshëm) menaxhoheshin nga gratë. Edhe në pozitat drejtuese në administratën komunale përfaqësimi i grave mbetet mjaft i ulët, me vetëm

20 për qind", thuhet në raport. Sipas këtij raporti, përveç në pozita drejtuese, në përgjithësi shkalla e grave të punësuar mbetet më e ulët se e burrave. "Përderisa shkalla e papunësisë te burrat, më 2019, ishte 22.8 për qind apo 6.3 për qind më e ulët se në vitin 2018. Shkalla e papunësisë te gratë ishte 32.7 për qind apo 2.1 për qind më e lartë se në vitin 2018. Pra, përderisa papunësia te burrat ka shënuar rënie, te gratë ka ndodhur e kundërta. E, në anën tjetër, interesimi i grave për të gjetur një vend pune është gati i të njëjtit nivel me atë të burrave. Numri i burrave punëkërkuar të regjistruar në Agjencinë e Punësimit në vitin 2019 ishte 52,343, kurse numri i grave punëkërkuar të regjistruar në agjencinë e punësimit ishte 43,547. Për më tepër, mbi 6,700 punëkërkuarë gra i kishin të përfunduara studimet bachelor, që është numër më i lartë sesa numri i burrave punëkërkuar me të



njëtin profil", thuhet në raportin e GAP-it. Ky është raporti i tretë vjetor

përmes të cilit, në mënyrë statistikore, Instituti GAP synon të vë në pah dallimet e

përfaqësimit të grave në tregun e punës, në arsim dhe mirëqenie sociale.

MF-ja mban punëtorë për investime në sektorin e arsimit të lartë dhe atë të ujërave



PRISHTINË, 30 JANAR (ER) - Ministria e Financave ka organizuar dy punëtori të ndryshme treditore për nevojat e investimeve në Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) si dhe në Arsimin e Lartë. Me këtë rast, ministri në detyrë i Financave, Lulzim Rafuna, ka deklaruar se qëllimi i këtyre punëtorive ishte që të mbahet

një diskutim i hapur rreth nevojave infrastrukturore në të dy sektorët dhe të analizohen mundësitë për një studim të fizibilitetit, rrjedhimisht të vlerësimit në tërësi të arsimit të lartë dhe gjendjes në sektorin e ujërave që pastaj do të jetë bazë për financim qoftë përmes donacioneve apo huamarrjes. "Në të dyja punëtoritë

pjesëmarrës ishin përfaqësues nga Banka Evropiane për Investime (EIB), Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës (CEB), përfaqësuesit e të gjitha KRU-ve dhe universiteteve publike, përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e

Integritimit Evropian, Zyra e BE-së në Kosovë, shoqëria civile, GIZ, KfW, si dhe përfaqësues të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Këto dy punëtori janë të parat e këtij lloji që organizohen nga niveli qendror sa i përket natyrës së punëtorive dhe numrit të pjesëmarrësve", thuhet në njoftimin e Ministrisë së

Financave. Sipas këtij njoftimi, në kuadër të këtyre punëtorive, pjesëmarrësit kanë vizituar edhe disa prej universiteteve publike dhe kompanitë rajonale të ujësjellësit të Mitrovicës, Ferizajt dhe Gjilanit, për të ndarë me të dyja bankat informacione më të hollësishme rreth problemeve me të cilat ballafaqohen këta sektorë.

FOL-i: Aneksautoudha Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë, rreth 5 milionë euro më shumë

PRISHTINË, 30 JANAR (ER) - Lëvizja FOL ka bërë monitorimin e të gjithë procesit të ndërtimit të autoudhës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë, i cili që nga fillimi është përcjellë me shumë parregullsi e që buxhetit të shtetit i ka kushtuar 88, 618,511.95 euro. Nga monitorimi që FOL ka bërë, së fundmi ka hasur në katër anekskontrata që Ministria e Infrastrukturës ka nënshkruar me katër operatorë ekonomikë që ishin fitues në tenderin për ndërtimin e mbi 22 kilometrave të kësaj autoudhe. "Gjatë vitit 2019 e deri më tani kjo autoudhë e paplanifikuar financiarisht po i kushton buxhetit të shtetit mbi 93 milionë euro, pa shtuar këtu edhe miliona të tjerë që kanë shkruar për shpronësime. Nga kontratat përmes procedurës me negociim pa publikimin e njoftimit për kontratë, kanë nënshkruar anekskontrata këta operatorë: 'Granit' sh.p.k me 1, 843, 392.24 euro, 'Companya Eskavatori' sh.p.k me 1,743, 107.70 euro, 'Gjoka Konstruksion' me 438,190.20

euro dhe 'Al Trade Holding L.L.C.' me 372,660.42 euro. Vlen të theksohet se operatorët ekonomikë 'Al Trade Holding L.L.C.' dhe 'Companya Eskavatori' sh.p.k në kontratat e mëhershme ishin në konsorcium me operatorë të tjerë, e që në këto anekskontrata nuk figurojnë emrat e tyre", është thënë në komunikatën e FOL-it. Sipas FOL-it, ajo që është më shqetësuese tri nga këto anekskontrata janë nënshkruar pas dorëheqjes së qeverisë Haradinaj. "Është me rëndësi të ceket fakti që Ministria e Infrastrukturës nuk ka pasur Plan të Menaxhimit të Kontratës, e i cili parashihet të jetë dokument në procesin e prokurimit, që përfshin në vete aspektet organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit dhe përmes të cilit plan bëhet monitorimi i punimeve në terren. Andaj, në si Lëvizje FOL kërkojmë nga Ministria e Infrastrukturës, si autoritet kontraktues, të sqarojë se mbi çfarë baze të vlerësimit ka nënshkruar këto




anekskontrata me operatorët ekonomikë të lartpërmendur kur mungon ky plani i menaxhimit. Punët dhe shërbimet shtesë, përmes këtyre anekskontratave, i kanë kushtuar buxhetit të shtetit plus 4, 397, 065.32 euro", theksohet në këtë komunikatë. Lëvizja FOL në muajin gusht

2019 është informuar nga IAP se Prokuroria Speciale ka filluar hetimet në kuadër të ndërtimit të autoudhës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë. "Ne, në këtë rast, kërkojmë nga Prokuroria Speciale të tregojë se në çfarë pike kanë arritur hetimet në ndërtimin e autoudhës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë.

Gjithashtu, FOL mirëpret pezullimin e tenderit 110 milionësh për vazhdimin e ndërtimit të kësaj autoudhe në një kohë kur vendi ende nuk ka buxhet të miratuar për këtë vit dhe nuk kemi zotim të mjetëve për vazhdimin e ndërtimit të kësaj autoudhe", është theksuar tutje në komunikatën e FOL-it.

Kosova anëtarësohet në Komitetin Ndërkombëtar për regjistrimin e kafshëve



PRISHTINË, 30 JANAR (ER) - Kosova është bërë anëtare e Komitetit Ndërkombëtar për Regjistrimin e Kafshëve (ICAR), organizatë kjo joqeveritare ndërkombëtare, e cila stimulon prodhimin e kafshëve në të gjithë globin në mënyrë më të qëndrueshme dhe më efikase. Anëtarësimi i Kosovës në ICAR, është bërë falë angazhimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) bashkë me Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ). Kosova në këtë komitet do të përfaqësohet nga MBPZHR-ja. Me anëtarësimin në këtë komitet,

Kosova do të përfitojë shumë sa i përket zhvillimit sipas standardeve të sektorit të blegtorisë. Nga tash, Republika e Kosovës do të ketë bashkëpunim në arritjen dhe zbatimin e rregullave dhe standardeve për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve riprodhuese, bashkëpunim me qëllim të harmonizimit të metodave për standardet e analizave të prodhimtarisë, bashkëpunimi në fushat që kanë të bëjnë me regjistrimin dhe vlerësimin e performancës së kafshëve, në standardizimin e Regjistrave të kafshëve sipas

standardeve të ICAR me qëllim të vlerësimit të vlerës së kafshëve dhe sistemeve të menaxhimit të fermës. Krahas këtyre përfitimeve, Kosova me këtë anëtarësim do të ketë edhe standardet dhe praktikën e mira për përdorimin e të dhënave të Regjistrimit të performancës me qëllim të vlerësimit të vlerës gjenetike të kafshëve. ICAR-i përbëhet nga 117 anëtarë nga 59 vende të ndryshme të botës dhe ky komitet me udhëzime dhe shërbime, ndihmon krijimin e sistemeve të prodhimit të kafshëve të bazuara në cilësi në të gjithë botën.

Zvogëlohet numri i udhëtarëve që shfrytëzuan trenin

PRISHTINË, 30 JANAR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin e radhës "Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit TM - 4/2019", me të dhëna mbi Transportin Ajror, Hekurudhor, Rrugor dhe Telekomunikimin për tremujorin e katërt (TM42019). Sipas ASK-së, në territorin e Kosovës kemi gjithsej 333 kilometra binarë hekurudhorë për transport. "Në tremujorin e

katërt të vitit 2019 numri i pasagjerëve që kanë shfrytëzuar trenin si mjet udhëtimi është rreth 31 mijë, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2018, numri i udhëtarëve është zvogëluar për 3.25 për qind. Transporti i mallrave me tren në tremujorin e katërt të vitit 2019 është rreth 138 mijë tonë, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2018 kemi ulje për 34 për qind. Sa i përket numrit

të fluturimeve në tremujorin e katërt të vitit 2019, kemi pasur 1 823 fluturime apo 2 për qind më pak se në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM 42018). Numri i udhëtarëve që kanë shfrytëzuar aeroplanin si mjet transporti gjatë këtij tremujori është rreth 528 mijë, në raport me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM 4 2018) kemi rritje për 5.71 për qind", thuhet në raportin e ASK-së.



Shënohet 30-vjetori i rënies së dëshmorëve Ali Kryeziu dhe Hysni Mazreku

MALISHEVË, 30 JANAR (ER) - Të enjten në Malishevë me një akademi përkujtimore është shënuar 30-vjetori i rënies së dëshmorëve të kombit, Ali Kryeziu dhe Hysni Mazreku, të cilët kanë rënë në altarën e lirisë më 30 janar të vitit 1990, në qendër të Malishevës. Po në këtë ditë ishin plagosur edhe 11 persona të tjerë, ndërsa ishin maltretuar shumë qytetarë. Me rastin e 30-vjetorit të rënies së tyre është shfaqur edhe një dokumentar i përgatitur për këtë ngjarje.

Në akademinë përkujtimore morën pjesë qytetarë të shumtë të Malishevës dhe më gjerë, strukturat komunale të Malishevës, ish-drejtuës të komunës nga vitet '90 e deri më tani, të cilët në fjalimet e tyre, si dhe në dokumentarin e shfaqur, kanë folur për jetën dhe veprën e dëshmorëve si dhe për rëndësinë historike të asaj ngjarje, pasi për herë të parë në Kosovë, krahas reagimeve popullore, filloi edhe reagimi institucional në raport me sistemin e atëhershëm.

Akademia ka filluar me një minutë heshtje në shenjë nderimi për dëshmorët Ali Kryeziu, Hysni Mazreku dhe policin "Hero i Kosovës", Sami Thaqi, i rënë dy ditë më parë në krye të detyrës.

Në fjalën e tij, i pari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka folur për ngjarjen, duke e cilësuar më të rëndësishmën në vitin 1990 në Malishevë, ku u vranë tre persona, u plagosën 11 të tjerë dhe shumë qytetarë u maltretuan.

Më pas, kryetari Begaj ka folur për dy dëshmorët Hysni Mazreku dhe Ali Kryeziu, si dhe për rëndësinë e asaj ngjarje, pasi për herë të parë Komuna e Malishevës, në rrugë institucionale, i ka dënuar vrasjet dhe ka kërkuar përgjegjësi nga organet kompetente për këto vrasje. "Ishte hera e parë që organet komunale, në mënyrë të hapur ishin me protestuesit dhe ishte hera e parë komuna reagon ndaj dhunës shtetërore të ushtruar ndaj popullatës, deri në ushtrimin e kallëzimit penal

ndaj përgjegjësve për vrasjen në Malishevë", ka deklaruar kryetari Begaj, duke kujtuar ngjarjen ka thënë se vrasje të këtilla ishin bërë në shumë komuna të Kosovës, por që asnjëherë nuk kishte regjistruar ndonjë reagim i tillë.

Për dëshmorët ka folur edhe kryetari i Degës së Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Sinan Gegaj, i cili ka kërkuar që të punohet edhe më shumë në realizimin e amanetit të dëshmorëve.

Ndërsa në emër të familjeve ka folur Avdyll Kryeziu, i cili i ka falënderuar të gjithë për pjesëmarrje në 30-vjetorin e përkujtimin të dy dëshmorëve.

Më pas është shfaqur edhe një dokumentar, kushtuar dëshmorëve Hysni Mazreku dhe Ali Kryeziu, ku kanë folur dhe i kanë treguar ngjarjet e asaj dite, të gjithë protagonistët, duke filluar nga familjarët, shokët, ish-udhëheqësit komunalë dhe aktivistët e tjerë, të organizuar në lëvizjet e kohës.

Në fund të kësaj akademie kryetari i Komunës së Malishevës,



Ragip Begaj, në bazë të kompetencave të tij, ka ndarë mirënjohje për udhëheqësit lokalë dhe delegatët e Kuvendit të Kosovës në vitet '90, me motivacionin "për reagimin institucional në mbrojtje të të drejtave dhe jetës së qytetarëve të Malishevës".

Me mirënjohje janë nderuar Daut Krasniqi, Rexhë Kastrati, Xhemajli Bajra postmortem, Halit Kreziu

postmortem dhe Selim Krasniqi postmortem, ndërsa këto mirënjohje do t'u jepen më vonë nga kryetari Begaj.

Pas përfundimit të kësaj akademie janë bërë homazhe dhe nderime në vendin e rënies, në "Sheshin e Dëshmorëve" në Malishevë, para pllakës së vendosur për dy dëshmorët, si dhe në varrezat e tyre në Malishevë dhe Bubavec.

Kuvendi Komunal i Rahovecit voton buxhetin për vitin 2020



RAHOVEC, 30 JANAR (ER) - Kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit, Afrim Dina, është mbajtur të enjten mbledhja e parë e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit dhe një ndër pikat e rëndësishme të kësaj mbledhje ishte miratimi i buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2020, ku me 21 vota për, 6 kundër dhe 1 abstenim, anëtarët e kuvendit e kanë miratuar buxhetin komunal për vitin 2020 dhe KAB-in për tre vjetet në vazhdim.

Vlera e buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2020 është 14

milione e 735 mijë e 820 euro, i shpërndarë në kategori; paga dhe mëditje 8,644,220.00; mallra dhe shërbime 1,594,330.00; shpenzime komunale 280,500.00; subvencione dhe transfere 311,000.00 dhe investime kapitale 9,905,820.00 euro

Gjatë mbledhjes anëtarët e Kuvendit Komunal kanë marrë dy vendime: Vendimi për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private dhe vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për

ndërtimin e Sheshit Qendror të Qytetit. Në këtë mbledhje janë shqyrtuar edhe këto dokumente: Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm sipas planit të veprimit për vitin 2019; plani i punës së kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2020; raportit vjetor financiar për vitin 2019; raportit i punës së kryetarit të komunës për vitin 2019 dhe raportit i punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2019 dhe Propozimi për tejkalimin e të hyrave vetjake për vitin 2019.

Kuvendi Komunal i Mitrovicës aprovon disa propozimvendime

MITROVICË, 30 JANAR (ER) - Nën drejtimin e kryesuesit Safet Kamberi dhe në prani të kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, nënkryetarit Faruk Mujka, asamblistëve dhe drejtorëve të drejtorive të administratës komunale, të enjten është mbajtur seanca e rregullt e Kuvendit të Komunës.

Fillimisht mbledhja ka filluar me një minutë heshtje, në shenjë nderimi dhe respekti për pjesëtarin e vrarë të Policisë së Kosovës, Sami Thaqi, gjatë ushtrimit të detyrës. Pastaj u propozuan disa pika shtesë për rend të ditës; Propozimvendimi për formimin e komisionit për

shqyrtimin e ankesave të përzgjedhjes së anëtarëve të bordit të Drejtorëve në Ndërmarrjet Publike Lokale dhe propozimvendimi për zëvendësimin e anëtarëve në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin e Komuniteteve.

Në këtë seancë, pas diskutimeve të zhvilluara, këshilltarët e Kuvendit Komunal aprovuan me shumicë votash propozimvendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2020; propozimvendimin për mbështetje financiare, subvencionim të transportit të

qumështit për fermerët; planin e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2020; planin strategjik të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën 2020-2022; planin e punës së Kuvendit për vitin 2020; raportin e punës së Kuvendit për periudhën janar-dhjetor 2019; propozimvendimin për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrjet Publike Lokale dhe propozimvendimin për zëvendësimin e anëtarëve në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin e Komuniteteve.



Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (14)

R2- sfera e fushës magnetike, primare e tokës



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Fusha e parë magnetike që ka buruar nga materialet feromagnetike në brendësinë e tornados elektromagnetike të tokës ishte fusha magnetike primare e tokës. Në këtë mënyrë kjo fushë e kishte burimin nga vetërigjenerimi i protoneve, elektroneve dhe neutroneve nga brendia e materialeve feromagnetike. Në mikrogrimcat (β), (δ) dhe (μ) të kësaj fushe që kanë buruar nga polet e magnetit të tokës, në to kanë vepruar njëkohësisht forca e fushës së ciklonit e ndihmuar edhe nga tornadoja elektromagnetike e tokës, e cila përmes forcës tërheqëse ka ushtruar presion mbi fushën magnetike primare të tokës. Në këtë mënyrë rreth tokës është formuar një sferë e fushës magnetike primare me një rreze të caktuar, por për shkak se fusha magnetike primare ishte kishte një burim vetërigjenerues, rrezja e saj gjithnjë ishte rritur me kalimin e kohës. Por formimi i shtresave të materialeve feromagnetike mbi polet e magnetit të tokës, e ka shndërruar këtë fushë magnetike primare në një fushë magnetike sekondare, e cila fushë ka filluar të burojë nga shtresa e materialeve feromagnetike.

Prandaj, gradualisht fusha magnetike sekondare me ndihmën e fushës antimagnetike simetrike e ka zhvendosur fushën magnetike primare në drejtim të periferisë. Në këtë mënyrë sfera e fushës magnetike primare është zhvendosur përtej sferës së fushës

fushës magnetike se sa nga rrezatimet e diellit ashtu sikur sot paralajmërohet nga agjenci të ndryshme shkencore. Erërat diellore e kanë burimin nga fusha magnetike primare e diellit, dhe kanë një rreze të caktuar nga sipërfaqja e diellit. Prodhimi i tyre ka përfunduar, por kanë mbetur këto mikrogrimca të shpërndara në ndikimin e forcës së fushës antimagnetike të diellit.

R3-Sfera e fushës antimagnetike të tokës (SBa)

Rrezja e fushës antimagnetike magnetike (SBa) ka një rreze shumë here ma të madhe se sa rrezja e fushës magnetike sekondare (SBs) dhe rrezja e fushës magnetike primare (SBp). Kjo sferë e fushës antimagnetike depërton nëpër dy sferat e fushave magnetike sekondare (SBs) dhe primare (SBp) dhe kalon përtej tyre me qindra mijëra kilometra. Ç'ka do të thotë se është prezentë në të dy fushat magnetike, që tregon se të dy sferat e fushës magnetike ndodhen brenda sferës së fushës antimagnetike, përderisa fushat magnetike primare dhe sekondare kanë një kufi në mes veti, fusha antimagnetike nuk ka kufij me asnjërin nga këto fusha magnetike. Rrezja e fushës antimagnetike magnetike (SBa) është e njëjtë me rrezen e forcës tërheqëse të fenomeneve të cikloneve dhe tornadove elektromagnetike, ashtu sikur shihet në figurën 21.

R3 dhe R5-Sfera e fushës së ciklonit dhe tornados elektromagnetike

Janë sfera që kanë një rreze të njëjtë, kurse së pari sfera është formuar rrezja e ciklonit të tokës, e pasuar nga sfera e tornados elektromagnetike.




Fig 21




Fig 22




Fig 22

Sferat brenda sferave te trupat qiellorë

Brenda pesë sferave të një trupi qiellorë mund të ketë nga një deri ($x...x_n$) sfera identike me dimensione shumë më të vogla se sa vetë dimensiononi i sferës. Shembull. Brenda pesë sferave të diellit, ndodhen sferat identike siç janë e tokës, Jupiterit, Saturnit, Uranit, Neptunit dhe Plutonit. Shiko figurën 23. Por ndryshe nga këto sfera të pesë shtresave, brenda ka edhe një sferë me më pak mbështjellës te planeti i Venerës, Merkurit, Marsit, Satelitëve Natyral, Hëna, Europa, Titani...




Fig 24

magnetike sekondare. Sfera e fushës magnetike primare është një sferë e cila përbëhet nga mikrogrimcat (β), (δ) dhe (μ) me një ($adn-y$) që janë tejet të rrezikshme për shëndetin e njeriut. Këto mikrogrimca janë në aktivitet të sulmit gjithherë mbi sipërfaqen e tokës për shkak se kanë nivelin energjetik më të lartë, se sa mikrogrimcat e fushës magnetike sekondare të tokës. Në këtë rast këto mikrogrimca nën presionin e forcës tërheqëse të fenomeneve (ct) do të depërtonin në sipërfaqen e tokës, por hasin në kundërshtim të fushës antimagnetike të tokës, të cilat kanë një nivel shumë më të lartë se mikrogrimcat e fushës magnetike primare. Prandaj, toka më shumë është e rrezikuar nga kjo pjesë e sferës së

Sferat e fushave të një trupi qiellor

Teoria e sferave të trupave qiellorë. Ç'do trup qiellorë i cili ka një formë të rregullt gjeometrike, dhe rreth të cilit rrotullohen trupa të tjerë qiellorë posedon pesë sfera në të cilat veprojnë fusha të ndryshme. Prandaj, sikur toka, dielli, jupiteri saturni, urani, galaksia e jonë, galaksitë e tjera miniuniverse apo universi posedon nga pesë fusha të veprimit në formë sferike që e mbështjellin atë trup. Shiko figurën 22. Rrezet e fushës antimagnetike, fushës së ciklonit dhe fushës së tornados elektromagnetike janë të njëjta $R3=R4=R5$.

vetëm 6000 km nga sipërfaqja e Marsit, i cili gradualisht i afrohet Marsit. Kështu që prezenca e këtyre sferave është tejet e komplikuar te ata trupa qiellorë që kanë në formë sferike dhe nuk rrotullohen rreth tyre trupa të tjerë qiellorë, ashtu sikur Venera e Merkurit.

Elasticiteti i sferave të trupave qiellorë

Kur është fjala te forma sferike e trupave qiellorë, nuk mund të themi se trupi qiellorë ka një formë 100 për qind sferike, ashtu sikur toka dhe trupa të tjerë qiellorë. Trupat qiellorë kanë një formë të caktuar dhe statike. Kurse për dallim nga vetë trupat qiellorë sferat trupave qiellorë pa marrë parasysh se sa shtresa përmbajnë në brendinë e tyre janë sfera elastike. Elasticiteti i sferave të trupave qiellorë varet nga dendësia e mikrogrimcave të fushës magnetike simetrike, qoftë primare dhe sekondare, si dhe nga mikrogrimcat së fushës antimagnetike dhe fushës tërheqëse të ciklonit dhe tornados elektromagnetike të atij trupi qiellor.

Venera dhe Merkurit posedojnë sfera shumë elastike, kurse marsi pak më të qëndrueshme, kurse toka dhe trupat e tjerë qiellorë posedojnë një elasticitet më të vogël. Elasticiteti i sferave të trupave qiellorë është i vetmi fenomen, që trupat qiellorë i lejon të afrohen por nuk i lejon të takohen. Në sferat e trupave qiellorë dominojnë dy forca kryesore: a) Forca e fushës tërheqëse të ciklonit dhe tornados të atij trupi, e cila vepron në sferën elastike me forcë nga periferia në drejtim të qendrës si dhe b) Fusha antimagnetike e atij trupi, që ka drejtim të kundërt me forcat tërheqëse të dy fenomeneve, e cila tenton që ta rrisë vëllimin e atij trupi.

Këto dy forca natyrisht arrijnë një ekuilibër në mes veti në secilën pikë të rrezes. Në këtë mënyrë në mes tokës dhe hënës veprojnë njëkohësisht dy forca, njëra është forcë tërheqëse dhe tjetra shtytëse, e që kanë intensitet të njëjtë në secilën pikë të orbitës së rrotullimit. Sfera e fushës tërheqëse të ciklonit dhe tornados elektromagnetike, është rritur gradualisht me rritjen e fushës antimagnetike të tokës, por rritja e fushës antimagnetike nuk mund të ndodhë pa rritjen e shtresës së materialeve feromagnetike mbi polet magnetike të tokës.




Fig 25

Fenomeni i rritjes së shtresës feromagnetike mbi polet magnetike të tokës, është indikacion mbi ekzistimin e fenomenit të njëjtë edhe te elementet e tjera brenda tokës, e së bashku këto fenomene njëkohësisht ndikojnë në rritjen e rrezen së tokës, e cila ndikon në rritjen e rrezës së fushës magnetike sekondare të tokës, të fushës antimagnetike, dhe distancën në mes tokës dhe hënës si dhe trupave të tjerë qiellorë, dhe në fund ndikon në rritjen e rrezes së jashtme të tokës.

Prandaj, rritja e këtyre fenomeneve brenda një trup qiellorë, tregon qartë se të njëjtat fenomene ndodhin njëkohësisht te të gjithë trupat qiellorë, galaksitë mini-universe apo rritjen e universit.

Rrezja e sferave të tokës, ndryshon kohë pas kohe, kjo rreze ndryshon gradualisht gjatë rrotullimit të tokës rreth diellit. Në janar të secilit vit, apo në perihel që është pozita kur toka është më afër diellit, sferat e tokës shtypen në njërin anë kohë pas kohe, por forca e ciklonit dhe e tornados i japë një formë të rregullt, ku këto sfera i zgjatë në të dy anët. Shiko figurën 24. Kurse në pikën më të largët kur toka nga dielli e merr formën sferike. Por pa marrë parasysh orbitën rreth të cilës rrotullohet toka rreth diellit, sferat e tokës ndërrojnë në ç'do kohë. Kjo e tregon edhe distanca e hënës me tokën ndërron kohë pas kohe.

Pastaj në muaji korrik 2020 sferat e fushave të tokës ndodhen në presion të madhe nga sferat fushave të Jupiterit, por gjithashtu edhe në sferat e fushës së Jupiterit ndikojnë sferat e fushave të Saturnit. Shiko figurën 25.

Prandaj, sferat e tokës dhe të gjithë trupave qiellorë ndryshojnë kohë pas kohe, por asnjë here nuk rrezikojnë të dalin nga ekuilibri, dhe gjithmonë marrin forma simetrie. Të gjithë trupat qiellorë, të gjitha sistemet diellore, galaksitë, mini-universet, dhe universi ndodhen në qendrat e sferave të fushave të veprimit të tyre. Asnjë përzjerje në mes këtyre sferave stabile nuk ekziston. Për aq sa rriten sferat për shkak të rigjenerimeve për aq rriten universi.

Universi nuk ka asnjë lidhje me Bing bangu sepse Bing bangu asnjëherë nuk ka ekzistuar. Universi zhvillohet në formë natyrale dhe asnjëherë nuk përfundon duke u zgjeruar. Ne asnjëherë nuk do ta dimë se kur ka filluar, por e dimë dhe jem të sigurt së asnjëherë nuk ndalet.

Rigjenerimi

Rigjenerimi i fushës magnetike simetrike është një udhërrëfyes që i hapë rrugë rigjenerimit jo vetëm materialeve feromagnetike, por të gjitha elementeve të sistemit periodik, dhe jashtë sistemit periodik, për të cilën do informoheni në një kohë jo të largët. (VIJON)

Netanyahu diskuton me Putinin për Planin e Paqes

MOSKË, 30 JANAR - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, është takuar me presidentin rus, Vladimir Putin, në Moskë, për të diskutuar planin amerikan të paqes për Lindjen e Mesme.

Netanyahu bëri një ndalesë në kryeqytetin rus, më 30 janar, pasi vizitoi Uashingtonin, ku presidenti i ShBA-së, Donald Trump, shpalli propozimet e tij të shumëpritura për paqen mes Izraelit dhe palestinezëve.

Plani u mirëprit nga lideri izraelit, por u përshëndet me gjakftohtësi në Kombet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian.

Iniciativa u prit me zemërim nga palestinezët dhe u hodh poshtë nga disa vende myslimane.

Netanyahu e përshkroi vizitën e tij në Moskë, si simbol të "forcimit të mëtutjeshëm të marrëdhënieve" dhe tha se ai dëshironte t'i dëgjonte pikëpamjet e liderit rus për planin e paqes së SHBA-së.

"Ju jeni lideri i parë me të cilin po flas për marrëveshjen e shekullit të Trumpit, pas vizitës sime në Uashington", tha ai.

"Unë mendoj se ekziston një mundësi e re, mbase edhe unike", shtoi Netanyahu.

Plani i Trumpit i ofron Izraelit

kontroll mbi vendbanimet hebraike në Bregun Perëndimor dhe Luginën strategjike të Jordanit si dhe shpall Jerusalemin si "kryeqytetin e pandarë të Izraelit". Dokumenti gjithashtu flet për mundësitë e krijimit të shtetit palestinez me kryeqytet në një pjesë të Jerusalemit Lindor, por vendos një seri kushtesh që duhet të përmbushen nga palestinezët.

Presidenti i autoritetit palestinez, Mahmud Abbas, menjëherë e hodhi poshtë planin si shumë pro-izraelit dhe tha se do të preferonte të vazhdonte bisedimet e paqes me ndërmjetës neutral.



Palestinezët kanë thënë se ata nuk e konsiderojnë Uashingtonin si një lojtar të paanshëm në konfliktin që po zgjatë me dekada.

Ndërkohë Rusia, vitet e fundit, ka kërkuar një rol më të madh në rajon - edhe si një ndërmjetës - midis izraelitëve dhe palestinezëve.

Britania del nga BE-ja, por pason periudha e vështirë e transicionit

Pas Brexit-it, më 31 janar, do të nisë periudha e transicionit midis BE-së dhe Britanisë, gjatë së cilës palët do të diskutojnë marrëdhëniet e ardhshme tregtare, e që pritet të zgjasë së paku deri më 31 dhjetor 2020

LONDËR, 30 JANAR - Bashkimi Evropian e la të ikën Mbretërinë e Bashkuar. Me votimin përfundimtar, të mërkurën në Parlamentin Evropian, divorci - i njohur si Brexit - merr fund sot (e premte).

Në një seancë në Bruksel, të ngarkuar edhe me emocione, ligjvënësit votuan me 621 vota për dhe 49 kundër Brexit-it.

"Ne do t'ju duam gjithmonë dhe kurrë nuk do të jemi larg", tha presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, duke iu adresuar ligjvënësve britanikë.

Pas Brexit-it, më 31 janar, do të nisë periudha e transicionit midis BE-së dhe Britanisë, gjatë së cilës palët do të diskutojnë marrëdhëniet e ardhshme

tregtare. Transicioni pritet të zgjasë së paku deri më 31 dhjetor, 2020.

"Tani e tutje bëhet fjalë për partneritetin tonë të ri me Mbretërinë e Bashkuar. Negociatat do të nisin dhe për të qenë e qartë: Unë dua që Bashkimi Evropian dhe Mbretëria e Bashkuar të mbeten miq të mirë dhe partnerë të mirë. Bëhet fjalë për miq të vjetër dhe fillime të reja", tha von der Leyen, ka njoftuar rfe.

Vendet e BE-së janë të përgatitura edhe për mundësinë që bisedimet për marrëveshje të tregtare me Britaninë të mos kenë sukses deri në fund të vitit.

Britania synon marrëveshje gjithëpërfshirëse tregtare bren-



da 11 muajsh, por ky plan kohor konsiderohet si tejet ambicioz nga vëzhguesit e diskutimeve mbi tregtinë.

"Ne nuk do t'i nënshtrohemi asnjë presioni dhe asnjë ngutje", tha presidenti i Francës, Emmanuel Macron, në Paris.

"Prioritet është t'i përcaktojmë, në një afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë, interesat e Bashkimit Evropian dhe t'i ruajmë ato", tha Macroni.

Von der Leyen tha se parakusht për t'i garantuar Britanisë qasje të favorshme në tregun e BE-së -

prej gati gjysmë miliardi konsumatorësh - është që "bizneset evropiane dhe britanike të vazhdojnë të konkurrojnë në një fushë të lojës".

"Ne duam të krijojmë një partneritet të ngushtë. Por, po ashtu e dimë se duhet të vendosim se si ta trajtojmë Britaninë si një vend të tretë", tha von der Leyen.

Ligjvënësi britanik i Parlamentit Evropian, Nigel Farage, i cili për dy dekada ka bërë fushatë për daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian, tha se tani "gjithçka mori fund".

"Dua që Brexit-i të nisë debatin edhe në pjesën tjetër të Evropës: Çfarë duam nga Evropa? Nëse duam tregti, miqësi, bashkëpunim, reciprocitet, ne nuk kemi nevojë për një Komision Evropian, nuk kemi nevojë për një gjykatë evropiane, nuk na duhen këto institucione", tha Farage.

Britania do të largohet nga Bashkimi Evropian pas 47 vjetësh të anëtarësisë. Është vendi i parë që lë BE-në.

Vendimi për Brexit është marrë në një referendum të mbajtur në vitin 2016.

Pompeo: Kina është kërcënimi më i madh i kësaj epoke

LONDËR, 30 JANAR - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, e përshkroi Partinë Komuniste të Kinës, si kërcënimin më të madh të kësaj epoke.

Pompeo po qëndron në Britani të Madhe për të diskutuar vendimin e Londrës, që kompania kineze Huawei, të ketë rol të kufizuar në rrjetin 5G.

ShBA-ja, përfshirë Pompeon dhe presidentin amerikan, Donald Trump, kishin lobuar që Londra ta përjashtojë Huaweiin nga planet e rrjetit 5G, për arsye sigurie.

Megjithatë, zyrtarët britanikë nuk morën parasysh vërejtjet e Uashingtonit.

"Kur ju lejoni që informacioni i qytetarëve tuaj, ose informacionin i sigurisë kombëtare të kalojë në rrjetin, në të cilin Partia Komuniste e Kinës ka një mandat ligjor që ta marrë atë, atëherë kjo krijon rrezik", u tha Pompeo gazetarëve.

"Jam shumë i sigurt se dy kombet tona, do të gjejnë një mënyrë, për të punuar së bashku në zgjidhjen e dallimeve", tha Pompeo.

Uashingtoni dyshon se Huawei

bashkëpunon me Qeverinë kineze, dhe se të dhënat e përdoruesve të saj nuk janë të sigurt.

Rrjeti 5G paraqet gjeneratën e fundit të lidhjes së telefonave të mençur me internet, dhe ofron shpejtësi të shkarkimit shumëfish më të shpejtë sesa ekziston aktualisht.

Huawei me qendër në Kinë, i ka mohuar vazhdimisht akuzat e Uashingtonit.

Duke folur së bashku me ministrin e Jashtëm britanik Dominic Raab, Pompeo tha se ai e konsideronte Partinë



Komuniste kineze si "kërcënimin kryesor të kësaj epoke" si dhe u bëri thirrje ShBA-së dhe aleatëve të saj, që të sigurohen

se posedojnë fuqinë ushtarake dhe teknologjike, për t'u siguruar se ky shekull qeveriset nga parimet përëndimore.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Pikëpamjet e profesor Rexhep Qosjes për Albanologjinë (5)

VII. Në mbrojtje të albanologjisë

Prof. asoc. dr. Myrvete DRESHAJ-BALIU
Prof. dr. Begzad BALIU

Gjatë viteve të tij shkencore dhe intelektuale profesor Rexhep Qosja është shquar në mënyrë të veçantë me përpjekjet e tij integruese në fushë të mendimit shkencor, si dhe për etikën e fjalës e të mendimit në kulturën shqiptare, në kohën kur ajo ndalohej për shkaqe politike, ideologjike dhe 'parimore'. Krijues, që nuk e ka pranuar dogmatizmin dhe folklorizmin, profesor Qosja me kohë është çliruar prej fjalësit ideologjik dhe fjalësit krahinor, por duke qenë krijues me njohje të gjerë të traditës kombëtare dhe trashëgimisë letrare të përbotshme, ai ka ditur t'i bëjë të përdorshme vlerat historike dhe mitike nacionale si vlera estetike universale.

Pas demonstratave të vitit 1981, ai u bë pjesë e lëvizjes së madhe studentore dhe kombëtare në mbrojtjen politike, fizike dhe qytetare të popullit shqiptar në Kosovë nga gjenocidi i politikës së Beogradit, duke u bërë edhe bardi moral e intelektual i saj. Në këtë periudhë, me fjalën e tij në Kongresin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë në Novi Sad, ai përfundimisht e ka bërë dejugosllavizimin e mendimit shqiptar.



Po në këtë periudhë atij i takoi të mbronte jo vetëm lirinë e popullit të tij, po edhe disa prej përbërësve etnikë, historikë e gjuhësorë të popullit shqiptar. Në mënyrë të veçantë mbrojtja albanologjinë si koncept, si dije, si kulturë dhe si vlerë institucionale shqiptare.

Kush nuk i kujton sot tekstet e tij, intervistat, polemikat, studimet dhe protestat e tij në shtypin jugosllav për shqiptarët dhe pozitën e tij në ish-Jugosllavi, ku albanologjia zinte gjithashtu vendin e veçantë. Kush nuk i kujton sot analizat dhe polemikat e tij, në mbrojtje të albanologjisë dhe të institucioneve të saj, si ai: Akademik apo censor, në mbrojtje të Fjalorit të gjuhës shqipe, (1985); esenë Atentate mbi kulturën, në mbrojtje të trashëgimisë etno-historike e kulturore të shqiptarëve në Maqedoni (1987); përgjigjen Fjala është, vërtet, për lirinë, albanologjinë dhe Shqipërinë, tekst i dërguar në gazetën e Beogradit Borba (1987) si përgjigje në reagimet që në këtë gazetë ishin botuar në lidhje me intervistën Liria që s'e kemi të botuar në gazetën slovene Delo (1987); esenë Ambasadori pa

vullnet të mirë, tekst i dërguar gazetës Borba (1988), si përgjigje në fejtovin e ambasadorit jugosllav në Tiranë Arsa Millatoviçit, Si i njohin shqiptarët; reagimin Albanizmi apo albanofobia, përgjigje në artikullin e Shoqatës së arsimtarëve universitarë dhe punonjësve të tjerë shkencorë të Serbisë dhe Shoqatës Shkencore të Serbisë, në të cilin veç tjerash Profesor Qosja ankohej për mungesën e bashkëpunimit me studiuesit dhe institucionet në Shqipëri; intervistën E drejta historike dhe e drejta etnike, për gazetën Delo (1989) etj. Të gjitha këto u botuan të përmbledhura në librin Fati i pambrojtur, në kroatishte, në mesin e të cilave pastaj edhe studimi Dobrica Qosiqi dhe çështja shqiptare (1989). Nuk e dimë a është e domosdoshme të theksohet se të mbroje albanologjinë në vitet '80 në Kosovë, ishte sikur të mbroje gjuhën shqipe në fund të shekullit XIX.

Në vitet '90, kur zëra të caktuar filluan të shquajnë karakterin krahinor (të kulturës shqiptare), dialektor (të gjuhës shqipe) dhe përdallues (të religjionit të shqiptarëve), duke e shquar njërin më shumë se tjetrin dhe madje njërin kundër tjetrit, Rexhep Qosja mbrojtja me guxim e tij intelektual pasurinë universale të qytetërimit shqiptar, pa dalluar prejardhjen Perëndimore, Lindore a Bizantine të tij. Dhe e bëri këtë edhe në një periudhë tjetër po kaq dramatike në jetën tonë. Situata të tilla për fat të keq në jetën tonë u përsëritën edhe më vonë, kur rrethana të reja u shfaqën jo vetëm në shoqërinë shqiptare në Shqipëri po edhe në shoqërinë shqiptare në Kosovë.

Në fillim të shekullit XXI kur shoqëria shqiptare po përpriqej ta kalonte rubikonin e tranzicionit demokratik në Shqipëri, dhe ndërtimin e institucioneve shtetërore në Kosovë, u shfaqën mjaft zëra, të cilët shquanin të ashtuquajturin identitet kosovar dhe të ashtuquajturën gjuhë kosovare, duke e kushtëzuar madje edhe mbivendosjen e një shtrese krishterimi në identitetin kosovar, si kusht për t'u identifikuar me përmbajtjen qytetëruese evropiane. Dhe zërat shfaqeshin në një kohë që hapësira e Kosovës ishte vetëm një hapësirë gjeografike e dizajnuar nga strukturat shtetërore jugosllave, që në kushte të reja të zhvillimeve ndërkombëtare po merrte konturat e një shteti të ri, ndërsa etnonimi përkatësisht etimologjia e emrit kosovar në kontekstin historik ishte vetëm një fjalë e prejardhur nga



slavishtja dhe e shtrirë andej në hapësirën sllave të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Në këto rrethana të reja, kur inteligjencia në Kosovë dhe përgjithësisht në gjithë hapësirën shqiptare merrej me probleme të karakterit partiak, klanor dhe personal, Profesor Qosja botoi traktatin Ideologjia e shpërbërjes, me të cilin atakoi jo thjesht individë a grupe të caktuara të interesit, po një dimension shumë shqetësues që rrezikonte të merrte përmasa historike në jetën e popullit shqiptar.

Në këtë rrjedhë veprat e tij, që më parë se letrare, kritike, polemizuese, dokumentare, historike, historiko-letrare, teorike etj., do të mund të quheshin me një emër të përbashkët: albanologjike,


shquhen për gjuhën e jashtëzakonshme dhe prurjet e tyre, jo vetëm të natyrës fonetike e fjalëformuese, por edhe sintaksore e stilistike, një arritje kjo rrallë e shënuar në letrat shqipe. Ata që kanë lexuar projektet e tij gjithëkombëtare për institucionet albanologjike dhe projektet nacionale për të cilat duhet të punonin në fund të viteve '60; ata që kanë lexuar konceptet e tij për gjuhën letrare në fillim të vitit '70; ata që kanë lexuar vlerësimet e tij për shqipen standarde dhe terminologjinë shkencore në studimet kritike dhe historiko-letrare të viteve '80; në të vërtetë ata që e kanë lexuar veprën e tij letrare, publicistike, historike, politike, historiko-letrare dhe polemike, nuk e kanë vështirë të kuptojnë pse ai e shquan kaq

shumë rëndësinë dhe pasurinë e gjuhës shqipe, si dhe dimensionin përbashkues të saj në jetën e popullit shqiptar. Për më tej, ata që e kanë lexuar dhe shijuar me kujdes pasurinë leksikore dhe kuptimore të fjalësit të tij, nuk e kanë të vështirë të shohin se pasuria e gjuhës shqipe nuk vjen vetëm prej një dialekti a një dialekti tjetër, por edhe prej dhuntisë së krijësit për të gjurmuar dhe pasuruar gjuhën e tij me fjalë, nocione, terma, neologjizma apo togfjalësia të rinj.

Për të gjitha këto arsye dhe shumë të tjera që nuk patëm mundësi t'i theksonim këtu, mund të themi se Profesor Rexhep Qosja më shumë se historian i letërsisë është albanolog në kuptimin e plotë të fjalës! (FUND)

Në një kohë kritike për dijetarët, nuk mund të ishe më i ndriçuar se të tjerët – pa u ndëshkuar...

Nga: Montesquieu (Fjalimi i pritjes në Akademinë e Shkencave të Bordosë, më 1 maj 1716)



Përktheu: Verjon FASHO

Dijetarët e antikitetit i merrnin dishepujt e tyre pa përzgjedhje apo testim: ata besonin se mençuria, ashtu si arsyeja, duhet të jetë e përbashkët për të gjithë njerëzit edhe se, për të qenë filozof, mjafton të kesh sadopak shije për filozofinë.

Zotërinj, sot mes jush ndodhem unë që nuk kam se ç't'ju paraqes tjetër veç një dashuri të madhe për studimet dhe shijen për letërsinë. Nëse, për ta marrë këtë nder, do të mjaftonte t'ia dija mirë çmimin dhe të ushqeja për ju respekt dhe konsideratë të lartë, mund ta mendoja veten plotësisht të denjë dhe mund të krahasohesha me atë trojan i cili meritoi mbrojtjen e një perëndeshe vetëm sepse iu duk fort e bukur. Po, zotërinj, e shoh akademinë tuaj si stolinë e krahinave tona; e shoh ngritjen e saj si ato lindjet e gëzueshme ku dijet qiellore kryesojnë gjithmonë.

Deri më tash shkencat i kishim parë jo vetëm të lëna pas dore, por të përbuzura, shijen tërësisht të prishur, letërsinë të struktur në errësirë të plotë dhe vjershat krejt

të huaja në atdheun e Paulinve dhe Ausoneve.^[1]

Gabojmë kur mendojmë se ishim të njohur te fqinjët tanë për mprehtësinë e mendjes tonë. Pa dyshim, kemi qenë për barbarinë e gjuhës sonë.

Po, zotërinj, ka qenë një kohë ku ata që iu dhanë me mish e shpirt studimeve u konsideruan si njerëz të çuditshëm, të cilët nuk ishin të një brumi me njerëzit e tjerë. Ka qenë një kohë ku shihej si diçka qesharake e aspak e natyrshme të çlirohesh nga paragjykimet e popullit dhe ku secili e shihte verbërinë e tij si një sëmundje fort të dashur, shërimi i së cilës përbente rrezik.

Në një kohë aq kritike për dijetarët nuk mund të ishe më i ndriçuar se të tjerët pa u ndëshkuar: nëse dikush merrte guximin të dilte nga një sferë e ngushtë që kufizon njohuritë njerëzore, një pafundësi insektesh që ngriheshin përnjëherësh formonin një re për ta errësuar atë; edhe ata që e çmonin në heshtje revoltoshin në publik dhe nuk mund t'ia falnin fyerjen që ua bënte duke mos u ngjarë atyre. Vetëm juve ju takonte t'i jepnit fund këtij mbretërimi apo kësaj

tiranie të injorancës: dhe ju e bëtë, zotërinj; kjo tokë ku jetojmë nuk është më dhe aq e thatë; dafinat rriten aty, për fat të mirë; po i këpusim ato nga të gjitha anët; studiuesit e të gjitha viseve ju kërkojnë kurora: *Manibus data lilia plenis*.^[2]

Është pak për ju që kjo akademi t'ju detyrohet si për krijimin ashtu dhe për zhvillimin e saj. E shoh më tepër si një trofe të madh, i ngritur për lavdinë tuaj, sesa si një kompani e cila duhet t'i përsosë shkencat: më duket sikur dëgjoj secilin prej jush të shqiptojë këto fjalë të poetit lirik: *Exegi monumentum ære perennius*.^[3]

U gjallëruam në këtë sipërmarrje të madhe nga ky mbrojtës i shquar, mendja edhe syri vigjilent i tij kujdeset gjatë gjithë kohës për ne.^[4] E kemi parë t'i lë mënjanë kënaqësitë e oborrit mbretëror dhe të ndihet i pranishëm deri në skajet më të largëta të krahinave tona. Pikërisht kështu na i paraqesin dhe rrëfenjat ato perëndi të dobishme që nga rehatitë e vendbanimeve të qiellit zbresin në tokë për t'u dhënë dritë popujve të egër ku të lulëzojnë në mes tyre shkencat dhe artet.

A do të guxoja t'ju rrëfeja, zotërinj, atë që modestia ime e ka mbajtur përbrenda deri tani? Kur shihja se si po ngrihej Akademia juaj aq e dashur, ndjeva një gëzim të madh thellë brenda vetes dhe, ose një instinkt miklues dukej sikur më kumtonte atë që po më ndodh në këto çaste, ose një ndjenjë vetëvlerësimi ma bëri ta shpresoja, gjithnjë i shihja dokumentet e themelimit tuaj (institucional) si të ishin pronë e vyer e familjes sime.

I lidhur me shumë prej jush nëpërmjet hireve të miqësisë, shpresoja që një ditë, me anë të këtyre të fundit, të bëhesha pjesë e një angazhimi të ri dhe t'u bashkoja atyre edhe marrëdhënien e letrave, meqë isha tashmë në mesin tuaj falë lidhjes më të fortë që ka ekzistuar mes njerëzve. Dhe, nëse ajo që thotë njëri prej poetëve tanë më gazmorë nuk është aspak marrëzi, që duhet të kesh prirje për të qenë njeri i ndershëm, a nuk mund të besoja se zemra, të cilën këto prirje e kanë zotëruar, do t'u shërbente si garanci për mendjen dhe shpirtin tim?

Ndiej sot, zotërinj, se nuk jam mburrur aspak me tepricë. Dhe,

qoftë që ju më keni dhënë hakun, qoftë që unë kam ditur t'i josh gjykesit e mi, jam njësoj i kënaqur me veten: publiku do të verbohët me këtë zgjedhje tuajën dhe nuk do të shohë më mbi kokën time veçse duart mjeshtërore që më kurorëzojnë. /Shkëputur nga libri "Ligjërata akademike", i cili është në proces botimi nga shtëpia botuese "Logos-A"/Revista "Akademia"/

[1] Paulin de Nole ose Shën Paulini, lindur në Bordo rreth vitit 353, vdekur në Nole në vitin 431. Poet dhe kishtar i shquar për shkrimin e vjershave dhe të poemave. Janë të famshme epistolarët e tij me poetin e shquar të kohës Ausone. (Shënim i përkthyesit).

Ausone (Decimus Magnus Ausonius), lindur rreth viteve 309-310 në Bordo dhe vdekur rreth viteve 394-395 në Langon, politikan, njeri i letrave dhe pedagog galo-roman. Mbi të gjitha, njihet si poet i madh i gjuhës latine në territorin gal. (Shënim i përkthyesit)

[2] Virgjili, Eneida, VI, v. 885 (Shpërndani lule me të dyja duart)

[3] Horaci, Odet, III, XXIV. (Ua kemi kaluar dhe monumenteve të bronzit)

[4] Henri-Jacques Nomparr de Caumont (1675-1726), duka La Force, Par i Francës, anëtar i Akademisë Franceze.



'Përbindëshi i rrumbullakët' tregim nga Alberto Moravia

Tregimi i mëposhtëm "Përbindëshi i rrumbullakët" i Alberto Moravias botuar në 1976 nga Mondadori, bën pjesë në përmbledhjen me 30 tregime të titulluar "Boh" (në proces përkthimi nga unë, D.K.). Boh është shprehja tipike italiane që përdoret më fort me gjuhën e trupit, shprehje e cila në këtë libër përmbledh gjithë dyzimet, moskuptimet, keqkuptimet që shekujt ia kanë akumuluar e depozituar në nënndërgjegjen e saj e që vështirë se do të arrijë ndonjëherë t'ia shpjegojë partnerit të saj. 30 tregime me 30 profile të ndryshme psikologjike grash! Njohës i thellë i dinamikave cerebrale e të pandërgjeshme të gruas, Moravia na jep një afresk sublim të vizionit të tij "feminist". Dhjetëra nuanca të holla të psikës femërore të treguara me një gjuhë të prerë, pa zburime, lakonike, gdhendëse, me raste mizore deri aty ku secila grua duke i lexuar do ta gjente veten tek të paktën njëri prej tyre. Filli i kuq që i përbashkon e i përshkon këto tregime, ai i botës asnjëherë të njohur saktësisht të gruas, na vjen me ngjyrat më të gjalla të një narrative mbresëlënëse.

**Përktheu nga origjinali:
Diana KASTRATI**

Ka njëzetë vjet tashmë që e kam lexuar Platonin, pikërisht atëherë kur isha studente dhe po diplomohesha në mjekësi. Nga ai lexim më ka

ngelur në kujtesë veçanërisht njëra prej përrallave, ajo e hermafroditit, sipas së cilës në zanafillat e njerëzimit ka ekzistuar një përbindësh i rrumbullakët me dy kokë, me katër krahë, katër këmbë, dy palë të ndenjura dhe dy sekse. Zeusi, i shqetësuar për forcën e përbindëshit vendosi ta

dobësonte forcën e tij kështu që e ndau në dy pjesë të barabarta, siç thotë Platoni, ashtu siç ndahet një vezë e zier me një teh të mprehtë. Që nga ajo kohë, këto dy gjysma seksesh, njëri femëror dhe tjetri mashkullor, shëtisin nëpër botë si të ndërkryer duke kërkuar gjysmën e seksit të ndryshëm

që t'i plotësojë dhe në këtë mënyrë t'i lejojë që të rikrijnë përbindëshin e fillimit. Pse më ka mbetur në kujtesë kjo përrallë? Sepse sipas meje kjo nuk është një përrallë, por një e vërtetë. Megjithë profesionin, kulturën, zgjuarësinë dhe përvojën time, unë jam përjetësisht në një kërkim të anktshëm e shkatërrues të gjysmës time mashkullore. Ky kërkim i vazhdueshëm dhe i dëshpërueshëm më çon të bëj marrëzira si për shembull tani teksa jam duke ngjitur shkallët e një shtëpie popullore në kërkim të një farë Marioje, një djalosh i ri që punon si kamarier në plazh në krahët e të cilit jam ndjerë e plotë dhjetë ditë më parë ndërsa pushoja në një hotel të Circeos.

Natyrisht që ashensori është i prishur kështu që kur arrij në katin e gjashtë pasi kam bërë me vrap dymbëdhjetë palë këmbë shkallë, mbetem të paktën për një minutë pa lëvizur para derës duke u mbushur me frymë. Mbi

pllakëzën prej tunxhi tek dera e jashtme është shkruar me shkronja korsive "Elda-moda", ndoshta për t'i dhënë paksa elegancë. Elda është emri i nënës së Marios. Ajo pllakëzë mendjemadhe dhe naive kontraston me thjeshtësinë e derës prej druri të lyer me një ngjyrë hiri të shëmtuar, me dyshemenë e ngushtë të mbytur nga një diell i egër, me shkallët e ndyra, me gjithë shtëpinë brenda. Ja, tani nuk dihas më. Zgjas dorën dhe i bie ziles.

Dera hapet menjëherë si për të vërtetuar vogëlsinë e apartamentit. Një grua me përparëse të zezë prej rrobaqepëseje, me një metër prej dylli të verdhë mbi sup dhe me fije peri të bardhë të shpërndarë kudo mbi gjoks, pa dyshim nëna e Marios, shfaqet në prak. Është një grua e bukur, por me një bukuri të rrënuar dhe të zymtë. Amësia, puna, ushqimi e kanë deformuar dhe rënduar. Duhet të ketë moshën time ose disa vite më pak, por

midis nesh sigurisht që unë dukem më e re, edhe sepse flokët e mi janë të lyer, ndërsa të saj të janë të thinjur.

Më shikon me mosbesim dhe më pyet se çfarë kërkoj. I përgjigjem me një gënjeshtëri që gjithsesi mban një të vërtetë. – Djali juaj është duke u kuruar tek unë. Më telefonoi mbrëmë duke më thënë se nuk ndjehej mirë dhe donte që unë ta vizitoja, prandaj erdha.

Pse them që është një gënjeshtëri që mban një të vërtetë? Sepse kështu filloi dashuria jonë, në një dhomë shërbimi të hotelit në të cilin qëndroja unë dhe ku të zihej fryma. Mario gjendej i shtrirë mbi një shtrat portativ të bërë rrëmujë nën përpëljet e një krize kolike. Unë rrija në anë të shtratit dhe i mbaja dorën. Ai mendohej të kontraktonte sa më pak që të ishte e mundur dhe, ndërkohë, me sytë e tij të ankthuar kërkonte gjatë gjithë kohës të mitë.

E ëma që duket si e mësuar me këto lloj gjërash, nuk çuditet as nga prania ime, por as nga preteksti. Thotë me një zë të nënshtruar: Po shkoj të shoh nëse është në shtëpi. Më kthen shpinën pa më ftuar të hyj brenda dhe zhduket pas një perdeje prej stofi që ndan hyrjen nga pjesa tjetër e apartamentit. E mbetur vetëm, ngurroj pak e pastaj hyj brenda. Hap perden, shikoj: një korridor i vogël me një derë prej xhami në fund që pa dyshim duhet të jetë banjoja; pas saj ka tri dyer. Llogaris: njëra derë është e kuzhinës, njëra për dhomën e provave, njëra për dhomën e Marios. Po e ëma ku flen? Sigurisht në dhomën e provave mbi një divan. Duke menduar, si të themi, topografikisht, mbaj vesh. Dera, që sipas meje i takon dhomës së Marios ka mbetur e hapur përgjysmë nga ku dëgjohet qartazi zëri i tij që mbyturazi diskuton me të ëmën. Papritmas, ajo shfaqet sërishmi aq sa unë nuk arrij as të kthehem edhe njëherë tek hyrja. Me zërin e saj të trishtë më thotë: Më vjen keq, por im bir nuk ndodhet këtu! E shikoj drejt e në sy. Ajo i reziston shikimit. Duke u dridhur e gjitha, bërtas: Ju gënjeni, djali juaj është këtu, ia dëgjova zërin! Ndërsa them këto fjalë turrem për nga dera e dhomës së Marios. Në këtë moment Mario del nga dhoma dhe më qëndron përballë.

Flokët e zinj e të ndritshëm i ka të shpupurishur; është në brekë e kanotiere dhe duket që sapo është ngritur nga shtrati. Vë re që mban nën sqetull një peshqir. Budallallëkshe mendoj se nuk e mbaja mend kaq të shkurtër, kaq të përpjestuar mirë dhe kaq

leshatak. Por, në të njëjtën kohë provoj një si ndjesi të shtyrjes drejt tij, si e çmendur dhe me urgjencë, aq sa, nëse nuk do ta përmbaja veten, me siguri do të vrapoja tek ai për ta përqaftuar, për t'iu ngjeshur trupit të tij me timin. Pikërisht ajo gjysma platonike që, pas një kërkimi të gjatë, ka gjetur më së fundi gjysmën tjetër. Hap gojën, shqiptoj: Mario... Ndalem si e paralizuar nga një mendim i menjëhershëm që Mario, për ndonjë arsye që nuk e di, as nuk do t'ia dijë për mua dhe, si pasojë, kam bërë gabim që e ndërmora këtë aventurë për të ardhur deri në shtëpinë e tij me pretekstin e marrë të vizitës mjekësore. Është pikërisht kështu. Mario më shikon një moment i ngrysur dhe ja ku nga ajo gojë aq e dashur shpërthen përulëse dhe e shëmtuar e shara, të themi nga ato tradicionalet e një burri të ri ndaj dashnores më të madhe në moshë. Shtoji gjithë kësaj edhe ndryshimet e shtresës shoqërore, të kulturës që, në imagjinatën time platonike, i kisha konsideruar si elementë të destinuar për t'u integruar reciprokisht. Shtoji, së fundi, të folurën e pagdhundur romane e përshtatshme për të asgjësuar sa hap e mbyll sytë edhe lidhjen më të fortë dashurore, me fraza dialektore të tipit: Ej, ç'dreqin don? Po kush të njeh ty? Je parë në pasqyrë ti, apo jo? Pa shih plakën njëherë, na dashka... – e të tjera si këto.

Frazat e tij më ndjekin e më mbështjellin ndërsa, e përhumbur, rrekem të tërhiqem si një pulë e frikësuar dhe e gafruar që ikën për të shpëtuar nga goditjet e fshesës së amvisës të tërbuar. Në këmbë tek dera, e ëma shikon me dyshim por edhe e qetë, herë mua herë Marion, mund të thuhet si me një simpati të njohur për mua. E kapërcej dhe dal në shkallë, por jo me aq ndxitim sa të mos shoh fyerjen e fundit ndërsa Mario futet në banjo duke përplasur me zhurmë derën me xhama.

Pas kësaj skene, më ndodh diçka e pazakontë, por e saktë; çdo mëngjes, aty nga ora pesë, më del gjumi e tronditur dhe menjëherë filloj të mendoj Marion, ose më mirë, nuk mendoj atë në kuptimin e shprehjes “të mendoj gjithmonë” që në fund të fundit do të thotë të mos mendosh, por t'i lëshohesh ndjenjës. Jo! Më ndodh që me imagjinatë përsëris skenën aq poshtëruese të dëbimit tim nga shtëpia e tij. E shoh veten tek i bie ziles së derës, tek gënjej të ëmën dhe tek hyj në shtëpi. Shoh Marion tek shfaqet duke më mbërthyer me një shikim nga koka tek këmbët, tek zbrazet kundra meje dhe tek futet ne banjo duke përplasur derën. Pikërisht në këtë pikë, mendoni pak,

sillem në anën tjetër dhe, më zë gjumi. Ja pra, nëse arrini të kuptoni këtë do ta merrni vesh cili është dallimi ndërmjet të kujtuarit dhe ripërjetimit. Të kujtosh do të thotë të nxjerrësh nga kujtesa një person, një ngjarje, t'i kundrosh ashtu siç bën me një gjerdan të vjetër që rrinte i mbyllur në një sirtar e pastaj ta vendosësh përsëri aty, do të thotë në atë të kujtesës dhe të mos e mendosh më. Të përjetosh përsëri, do të thotë të provosh e të riprovosh, pa fund, ndjesitë që ai person apo ajo ngjarje kanë ngjallur tek ne ndërsa i përjetonim. E në fakt, kujtohet vetëm një herë, por përjetohet pafundësisht. Me një dallim ama: askujt nuk i bie ndër mend të ripërjetojë ndjesitë e pakëndshme. Përjetohen vetëm ndjesitë e pëlqyeshme, të tjerat sforcohen t'i harrosh. Si shpjegohet atëherë që unë, çdo mëngjes, me qindra herë, kthehem të kujtoj skenën e dëbimit nga shtëpia e Marios duke u ndalur veçanërisht në detajet më poshtëruese e më të pamëshirshme? Pse ngurroj, e topitur dhe e mahnitur që të shijoj sërishmi atë dhimbje të thekët si të ishte një kënaqësi turbulluese? Mendohem gjatë dhe, në fund i them vetes që faktikisht, gjatë atyre rikthimeve të kujtimeve mëngjezore, një si alkimi psikologjike ma shndërron gjithë atë dhimbje në kënaqësi. Mund të thuhet: mazokizëm. Ndoshta.

Po si është e mundur që të pajtohen mazokizmi me këtë dëshirë të ankthshme për të gjetur gjysmën tjetër, për të formuar edhe një herë përbindshin e rrumbullakët mitik të Platonit? A mund të quhet i plotësuar një person i ndarë në dy pjesë, njëra prej të cilave poshtëron, ofendon e degradon tjetrin? Me sa duket, po. Ajo dhimbje e imja epshore, më së fundi, pas disa muajsh, shndërrohet në një diçka të pashijshme, të dobët. Skena e dëbimit tim nga shtëpia e Marios zbehet, fillon të fshihet përgjysmë ashtu si një film i vjetër i konsumuar nga koha e nga përdorimi. Por, fatkeqësisht, tashmë jam mësuar me atë ëndje të kobshme, kam nevojë absolute të provoj çdo mëngjes vuajtjen e atyre pak minutave rrëqethës. Kështu, marr një vendim ndoshta të pabesueshëm por, në gjendjen në të cilën ndodhem më ngjan mjaft logjik. Do të paraqitem përsëri në shtëpinë e Marios, do t'i nxjerr të njëjtin pretekst të pafytyrë të vizitës mjekësore. Do të dëbohem sërishmi në të njëjtën mënyrë fyerëse, madje ndoshta Mario do të më kapë për flokësh e do të më plasë për tokë tek hyrja e apartamentit e pastaj duke më shqelmuar do të më hedhë për shkallësh.


Ashtu si ai i droguari që ka marrë dozën e preferuar të tijën, do të kthehem në shtëpi me goxha “furnizim” poshtërimi aq sa më duhet për ta zgatur akoma edhe për një kohë të gjatë.

Pa ngurruar e vë në jetë planin. Herët në mëngjes paraqitem në pallatin “popullor”, i ngjes në këmbë (ashensori është ende i prishur) të gjashtë katet, i bie ziles, e ëma ma hap derën, dhe recitoj gënjeshtren e vizitës mjekësore. Pres që mamaja e tij të më shtyjë me atë trishtimin e saj të dellëzuar me simpati. Pres që Mario të shfaqet dhe të hakërrehet kundër meje. Asnjë prej këtyre. E ëma, gjithmonë me atë pamjen e trishtë më fton: Mund të shkoni drejt e në dhomën e tij. Është në shtrat. Dera e fundit djathtas! – dhe largohet. Më shumë e vdekur se e gjallë bëj disa hapa dhe trokas në derë. Nga brenda më thuhet që të hyj. Ja, dhoma e vogël dhe e veshur me figura artistësh e lojtarësh futbollit të prera nga revistat. Mario është i shtrirë në shtrat, në shpinë ndërsa duart i ka të mbledhura poshtë zverkut, në brekë e kanotiere ashtu si herën e fundit. Nuk ngrihet, nuk lëviz, kufizohet të më thotë me një zë sa të ashpër aq edhe të sjellshëm: A mund ta di pse nuk u bërë më e gjallë? Apo ngaqë atë ditë isha pak i ashpër? A e di që je vërtetë e

çuditshme?

Papritmas impulsi për t'u hedhur tek ai për ta përqaftuar, për ta ngjitur trupin tim me atë të tijin më kalon si një magji. Më pas, ndodh diçka automatike, mekanike. Ulem tek bordura e shtratit, i marr pulsën dhe i numëroj të rrahurat. Ai proteston, në fillim i pasigurtë pastaj me më shumë vendosmëri. Nuk i vë vesh. Me ftohtësi profesionale e refuzoj përpjekjen e tij për të më përqaftuar. Ngrihem. I them që nuk është në gjendje të mirë. Marr bllokun e recetave, shkarravis një dhe ia jap. Kësisoj, pa i dhënë kohë që ta rimarrë veten nga habia, dal nga dhoma e pastaj nga apartamenti dhe zbres shkallët.

Ndërsa hip në makinë për të filluar xhiron e zakonshme të vizitave të mia, papritmas më vjen për të qeshur. Në fakt, më vjen ndër mend që përbindëshi i rrumbullakët i Platonit duhet të ketë ecur në mënyrë qesharake duke u rrotulluar me ato katër krahët e tij dhe me katër këmbët, ashtu si akrobatët apo si disa hyjni indiane. Pikërisht kështu! E ç'mund të bëjë tjetër një qenie kaq e çuditshme e cila bashkimin e saj ia detyron ndarjes, forcën e saj ia detyron dobësisë dhe gëzimet, dhimbjeve?! / *exlibris.al*



E rrallë

Superjahti që i ngjan një aeroplani

Prodhuesi i anijeve italiane "Codecasa" ka zbuluar planet për konceptin e ri të këtij superjahti. I projektuar nga Fulvio Codecasa, anija e re është formësuar porsin një aeroplan, teksa shihet që ka marrë karakteristikat e tij. Kjo anije ka tiparet e një aeroplani, dritare të rrumbullakosura, një hark që i



ngjan hundës së një aeroplani, vetëm pse kjo "fluturon" në det.

BARSOLETA E DITËS



Një burrë tepër i emocionuar merr doktorin në telefon.

- Doktor, si t'ia bëj? Po më lind gruaja dhe dhimbjet i ka shumë të shpeshta.
- Fëmija i parë, pyet doktori?
- Jo more idiot, jam burri.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan




Çdo natë në ora 20:00

STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30

THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

FOTO E DITES



Një tufë elefanti shihet duke kërkuar ushqim në një zonë të pyllëzuar në periferi të Gauhatt në Indi. /AP/

E jashtëzakonshme

Ushtria australiane përkëdhel dhe ushqen koalat që i kanë shpëtuar nga vatrat e zjarrit

Ushtarët australianë u kanë dalë në ndihmë dhjetëra koalave që i kishin shpëtuar nga vatrat e zjarrit, që tash e disa muaj e kanë kapluar këtë vend. Dhjetëra ushtarë dhe



ushtarë shihen duke ledhatuar koalat që i kishin mbështjellë me batanije, në kohën kur ato po ushqeheshin në parkun Cleland në Crafrers në jug të Australisë.



DASHI
Do ta keni shumë të nevojshme të çlodheni fizikisht. Madje rekomandohet që të shkoni në një qendër relaksimi.



DEMI
Ka gjasa që partneri/partnerja juaj t'ju bëjë një surprizë tejet të këndshme gjatë ditës së sotme.



BINJAKËT
Ka gjasa që t'ju duhet të shpenzoni një shumë të konsiderueshme parash për një çështje emergjente, çfarë do të ndikojë ndjeshëm në gjendjen tuaj



BRICJAPI
Disa persona të kësaj shenje duhet të bëjnë shumë kujdes nëse do t'ju duhet të transferoni para.



LUANI
Presioni në punë dhe në shtëpi do t'ju bëjë gjaknxehtë. Mos qëndroni pasiv, por përpuni ta jepni ndihmën tuaj në detyra të ndryshme.



VIRGJËRESHA
Do të jeni të mbushur me mendime pozitive dhe do të dëshironi t'i jepni sugjerime familjarëve apo të afërmve tuaj.



PESHORJA
Dikush do t'ju falë paqe dhe momente të qeta. Do të dëshironi të bisedoni gjatë me të. Sa i përket anës financiare, mos e harroni asnjëherë rëndësinë e parave dhe mendohuni mirë para se të shpenzoni.



AKREPI
Bëni kujdes me ilaçet që merrni vetë në shtëpi, pasi mund të bëheni të varur prej tyre. Mos i neglizhoni asnjëherë këshillat e mjekëve.



SHIGJETARI
Dikush mund t'jua vërë në provë durimin. Do të ishte e udhës të mos shkëlqenit vlerat tuaja dhe tregohuni të arsyeshëm në çdo vendim që mund të merrni.



BRICJAPI
Mund ta nisnin ditën me joga ose meditim. Duke vepruar kështu do të keni mjaft përfitime dhe do të mund ta ruani energjinë në nivelin e duhur gjatë gjithë ditës.



UJORI
Miqte mund t'ju prezantojnë me një person shumë special, i/e cila do të ndikojë pozitivisht në jetën tuaj.



PESHQIT
Nuk do të jeni shumë i qendrueshëm emocionalisht. Ndaj bëni shumë kujdes me mënyrën sesi silleni dhe si reagoni përballë të tjerëve.

Blake Lively thotë se fëmijët e saj e dinë profesionin që ka, por jo edhe kuptimin



Aktorja e njohur Blake Lively ka treguar se a e dinë fëmijët e saj se çfarë profesioni ka ajo dhe bashkëshorti i saj. Blake këtë e bëri me dije në një intervistë për "People" gjatë premierës së filmit të saj "The Rhythm Section". Ajo dhe bashkëshorti i saj, Ryan Reynolds,

njihen si aktorë shumë të njohur, pasi kanë qenë pjesë e shumë filmave të famshëm. "Fëmijët e dinë se ne jemi aktorë, por ata nuk e dinë funksionin e këtij profesioni", ka thënë Lively. Ajo dhe Reynolds kanë dy vajza, Inezin trevjeçare dhe Jamesin pesë muajsh.

Dalin në shitje biletat për koncertin e Malumës në Tiranë



Pas konfirmimit se këngëtari Maluma do të këndojë në Tiranë për ta festuar Ditën e Verës, tani janë zbuluar edhe disa detaje të tjera. Tashmë kanë dalë biletat në shitje dhe thuhet se bileta 'meet & greet' kushton 370 dollarë, ndërsa tani u bë i ditur

çmimi i biletave për gjithë ata që janë të interesuar ta ndjekin nga afër këtë koncert. Në rrjetet sociale tashmë u konfirmua se biletat kanë dalë në shitje dhe çmimi i tyre është 3000 lekë (25 euro) në "Mimoza zone", ndërsa 4 500 lekë (38 euro) në "Cherry zone".



Princi Harry vuajti shumë nga ndarja prej familjes mbretërore

Puna ka ecur normalisht për familjen mbretërore britanike pas njoftimit të fillimit të janarit se Princi Harry dhe Meghan Markle do të largoheshin nga detyrat e tyre mbretërore. Sidoqoftë, vendimi i tyre për t'u ndarë nga familja mbretërore dhe për ta shpërngulur familjen e tyre në Kanada nuk u mor lehtë. "Unë fola me Harry disa ditë më parë", ka thënë

shoku i Harryt, Nacho Figueras për "ABC". "Ai ka vuajtur shumë nga të gjitha gjërat që i kanë ndodhur. Ai vuan shumë nga njerëzit që e gjykojnë atë. Ai është një baba, një djalë që po përpiqet të mbrojë të voglin dhe luaneshën e tij nga gjithçka që kërkon. Ai është bërë një njeri i jashtëzakonshëm, një njeri për të cilin do të krenohej nëna e tij", ka treguar Nacho Figueras.

Drake me befasi të këndshme për nënën



Drake uroi në mënyrën më të mirë të mundshme nënën me rastin e ditëlindjes. Drake këtë rast ai e befasoi duke e dekoruar shtëpinë pikërisht për të. Vetë Drake ka publikuar një fotografi në rrjetet

sociale nga ambienti i shtëpisë super luksoze ku shihen balonat me mbishkrimin "Urime ditëlindjen". Kësaj fotografie ai ia shtoi edhe fjalët: "Urime ditëlindjen për nënën time të pabesueshme!"

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Marmarinos, përzgjedhës i ri i Kosovës në basketboll

Federata e Basketbollit ka njoftuar se Christos Marmarinos do të jetë trajner i ri i Kosovës, kurse ai do të prezantohet në javën e dytë të muajit shkurt ku do të bëhen të ditura edhe detajet e kontratës. "Trajneri i ri i Kosovës do të jetë në Final 8 të Kupës së Kosovës, që do të mbahet nga 11 deri më 15 shkurt në Rahovec. Gjithashtu, në javën e dytë të muajit shkurt do të mbahet një konferencë, ku do të prezantohet para medieve dhe do të bëhen publike detajet e kontratës", thuhet në njoftimin e FBK-së

"Epoka e re"

PRISHTINË, 30 JANAR - Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) e ka emëruar përzgjedhës të ri në Përfaqësuesen A të Kosovës, Christos Marmarinos. Ky i fundit ka qenë ndihmëstrajner në shumë skuadra të njohura evropiane, duke fituar shumë trofe, madje edhe te skuadra e San Antonios në kampin veror, derisa së fundi ishte trajner në Japoni te skuadra Nishinomiya Storks. Ai karrierën e trajnerit e filloi si ndihmëstrajner më 1995-96 në Ment Thessaloniki për gjeneratat U16 të meshkujve. Më pas për dy vjet vazhdoi në Aris Thessaloniki si ndihmëstrajner për U18 dhe U16 meshkujt, duke fituar titullin. Më 1998-99 ishte trajner i parë i U18, ku fitoi garat regjionale dhe ishte në stafin e Greqisë U18. Në edicionin 2000-2001 ishte ndihmëstrajner i Armond Hillit në Columbia University, përgjegjës për zhvillimin e lojtarëve. Më 2001 ndihmëstrajneri i Greqisë që u rendit në vendin e dytë në Lojërat Mesdhetare. Ishte përgjegjës për zhvillimin e lojtarëve. Në vitet 2001-2004 ishte ndihmëstrajner në ekipin e njohur grek Panionis, ku kishte shumë përgjegjësi dhe puna e tij bëri që më 2012 të shkonte në kampin veror të NBA-së te skuadra e San Antonios, ku ishte përgjegjës për zhvillimin e lojtarëve të rinj. Në shkurt të vitit 2013 ishte trajner në All Star-in e U21 në Greqi, duke drejtuar shumë lojtarë elitare grekë të anëtarëve të Ekipeve Kombëtare. Ai për shumë vite (2004-2018) ishte ndihmëstrajner në skuadrën e njohur evropiane, Olympiacos, ku fitoi shumë trofe, derisa ishte përgjegjës



për zhvillimin e lojtarëve të rinj, përgatitjen e stërvitjeve dhe ndeshjeve. Fitoi dy herë Euroligën, 2012 dhe 2013, tri herë finalist në Euroleague 2010, 2015, 2017, gjashtë herë në "Final 4" të Euroleagues (2009, 2010, 2012, 2013, 2015, 2017). Tri herë fitoi titullin në Greqi (2012, 2015, 2016), 12 herë finalist në Greqi (2006-2018), finalist i Kupës së Greqisë (2008-2013), fitues i Kupës së Greqisë (2010, 2011). Më 2015 ishte zgjedhur nga Euroleague si ndihmës trajneri më i mirë i vitit. Ai ka punuar edhe si komentator dhe analist i ndeshjeve të NBA-së, derisa ka punuar dhe punon si këshilltar i basketbollit, ku ka punuar me lojtarët, ekipet dhe institucionet që ofrojnë këshilla dhe njohuri trajnimi për përmirësimin e individëve dhe organizatave. Lista e

klientëve përfshin lojtarët e NBA-së dhe Euroligës. Marmarinos së fundi ka doktoruar në Filozofi (PHD), analist i basketbollit. "Trajneri i ri i Kosovës do të jetë prezent në Final 8 të Kupës së Kosovës, që do të mbahet nga 11 deri më 15 shkurt në Rahovec. Gjithashtu, në javën e dytë të muajit shkurt do të mbahet një konferencë, ku do të prezantohet para medieve dhe do të bëhen publike detajet e kontratës", thuhet në njoftimin e FBK-së.

Kosova në parakualifikimet për Kupën e Botës 2023 ndodhet në një grup me Islandën, Luksemburgun dhe Sllovakinë. Ndeshjen e parë "Dardanët" do ta zhvillojnë përballë Islandës në Prishtinë më 20 shkurt, derisa më 23 shkurt do të përballen me Luksemburgun në udhëtim.

SHKURT

Zbulohet orari i ndeshjeve çerekfinale të kupës

Federata e Futbollit të Kosovës ka njoftuar se është caktuar orari i ndeshjeve të fazës çerekfinale të Digitalb Kupës së Kosovës. Ndeshja e parë në këtë fazë është ajo në mes të Drenicës dhe Gjilanit, e cila zhvillohet më 8 shkurt, në orën 12:30, në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj. Në të njëjtën ditë do të zhvillohet edhe ndeshja ndërmjet Prishtinës dhe Vushtrrisë, por me fillim në orën 13:00. Më 9 shkurt do të luhet ndeshja ndërmjet Dukagjinit dhe Ballkanit, derisa dueli ndërmjet Lirisë dhe Feronikelit zhvillohet më 12 shkurt.

Besa përforcohet me katër futbollistë

Kampionët vjeshtorë në Ligën e Parë po vazhdojnë përgatitjet për stinorin pranveror. Pejanët nën drejtimin e trajnerit Miftar Rama tashmë fazën përgatitor po e zhvillojnë nga dy herë në ditë. Në këtë afat kalimtar, drejtuesit e klubit e kanë rikthyer malazezin Blazo Rajoviq në radhët e tyre. Skuadrës nga "Shahin Haxhiislami" u janë bashkuar edhe Agon Xhaka, Qëndrim Dautaj, Almedin Murati, bën të ditur Radio Televizioni "Dukagjini". Tre herë kampionët e vendit do të përforcohen edhe me dy ose tre futbollistë deri në fundin e afatit kalimtar të janarit. Nga skuadra e Besës deri më tani është larguar vetëm Robert Gjeraj.

Neziri rikthehet te 2 Korriku

Portieri Flamur Neziri, pas një karriere të gjatë e të suksesshme, ka vendosur të rikthehet sërish në skuadrën e 2 Korrikut nga Prishtina. "Rikthehem në klubin FC 2 Korriku, aty ku kam filluar hapat e parë të karrierës. Shpresoj dhe besoj që së bashku do të punojmë me të gjitha forcat dhe ta nderojmë fanellën e klubit me sukses", ka thënë Neziri.

Zogiani ndahet me Bashkimin

Futbollisti i mirënjohur Visar Zogiani është larguar nga KF Bashkimi nga Koretini. Mesfushori që ka luajtur për shumë klube në Kosovë i ka uruar suksese kësaj skuadre, por nuk e ka zbuluar të ardhmen. "Ju njoftoj se më nuk do të jem pjesë e KF Bashkimi nga Koretini. Falënderoj kryesinë, trajnerët, bashkëlojtarët, tifozët dhe gjithë fshatin Koretin për mbështetjen që më bënë për aq kohë sa isha pjesë e tyre. Klubit i uroj sukses në arritjen e objektivit", ka thënë Zogiani.

Kosova pëson humbje nga Gjermania

PRISHTINË, 30 JANAR - Përfaqësuesja e Kosovës në futsal ka pësuar humbje në ndeshjen e dytë në kuadër të Grupit F në fazën e parë kualifikuese për "Euro 2022", që po zhvillohet në Gjeorgji. Pas fitores kundër Austrisë, "dard-

anët" janë mundur nga Gjermania me rezultat 8:4. Djelmoshat e Ramadan Cimilit e nisën mirë ndeshjen dhe qysh në minutën e parë e gjetën golin nëpërmjet Drilon Maxharrajt. Mirëpo, gjermanët u kundërpërgjigjën me

golat e Onur Saglam, në minutën e 9-të dhe Michael Meyer, në minutën e 14-të, duke shkuar në pushim me epërsi të një goli. Edhe pjesën e dytë Kosova e nisi shumë mirë, kur fillimisht shifrat i barazoi Malush Qerimi në minutën e

23-të, derisa dy minuta më vonë Drilon Maxharraj shënoi për ta rikthyer epërsinë e Kosovës, 3:2. Gjermanët i barazuan shifrat në minutën e 29, me golin e realizuar nga Muhammet Sozer, por vetëm një minutë më vonë Melos

Kelmendi e riktheu sërish epërsinë e "dardanëve" (4:3). Në pesë minutat e fundit gjermanët arritën të përmbysin gjithçka me golat e realizuar nga Jonas Hoffmann (35'), Michael Meyer (36', 39') dhe Christopher Wittig (38').

Berisha, pas prezantimit: Doja të vija te Fortuna

DUSSELDORF, 30 JANAR - Mesfushori i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Valon Berisha, është prezantuar në skuadrën e Fortuna Dusseldorfit. Ka qenë vetë klubi gjerman që e

ka bërë zyrtar këtë afrim nëpërmjet një komunikimi në faqet zyrtare. "Nga dita e parë unë do të bëj gjithçka që është e mundur për ta ndihmuar ekipin në mënyrë që ta arrijmë qëllimin

tonë të madh, të qëndrojmë në ligë. Në bisedat me Lutz Pfannenstiel, por edhe me drejtorin sportiv të Lazios, Igli Tare, i cili ka luajtur edhe për Fortunan, kam një ndjenjë tejet të mirë.

Pas kësaj, me të vërtetë doja të vija te Fortuna", ka thënë Berisha, i cili ekipit gjerman iu ka bashkuar në formë huazimi dhe me të drejtë blerje në fund të këtij edicioni.



KOK-u publikon rezultatet e kategorizimit të federatave të sportit për 2020

PRISHTINË, 30 JANAR - Komiteti Olimpik i Kosovës ka publikuar rezultatet e kategorizimit të federatave të sportit, sportistëve dhe trajnerëve për vitin 2020. Në konferencë për media presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, u shpreh se komisioni për kategorizimin e këtyre federatave ka punuar më shumë se një javë për një gjë të tillë. "Komisioni i formuar nga KOK-u, në bazë të autorizimeve që vijnë nga Ligji për Sport i Republikës së Kosovës, ka punuar më tepër se një javë dhe bazuar në informatat që janë sjellë nga federatat e verifikuara drejtpërdrejt nga komisioni kanë dalë rezultatet të cilat do t'i shpalesh sekretari i përgjithshëm i KOK-it, i cili ka qenë njëkohësisht edhe kryetar i këtij komisioni. Na gëzon fakti se gjithnjë e më pak ka ankesa në rezultatet që dalin në kategorizimin e sporteve. Ky kategorizim është padyshim një e arritur jashtëzakonisht e madhe, është dinamike dhe sa herë që federatat i plotësojnë kriteret ose nënkriteret ajo federatë shkon më lart", ka thënë Hasani. Sekretari i përgjithshëm i KOK-it, Shasivar Haxhijaj, u shpreh se janë munduar që të bëjnë një punë të mirë duke kategorizuar federatat nëpër kategoritë të cilat ato i kanë merituar, raporton "KP". "Ne e kemi bërë një punë të gjatë deri në arritjen e rezultateve finale, do të thosha të kategorizimit të këtyre kategorive pra sporteve,



sportistëve dhe trajnerëve. Në total janë kategorizuar 33 federata sportive, kemi edhe disa federata që kanë aplikuar dhe nuk kanë kategorizuar fare, mirëpo kemi edhe disa federata që janë aktive të cilat fare nuk kanë aplikuar", ka thënë Haxhijaj. Sipas kategorizimit për vitin 2020, federatat sportive do të jenë të ndara në katër kategori, A, B, C, D. Në kategorinë A ishin të përfshira: Federata e Xhudos me 86.40 pikë, Federata e Futbollit me 79.28 pikë, Federata e Karatesë me 78.46 pikë, Federata e Hendbollit me 76.05 pikë, Federata e Volejbollit me 74.59 pikë dhe Federata e Basketbollit me 73.55. Në kategorinë B janë: Federata e Mundjes me 66.29 pikë, Federata e Boksit me 65.54 pikë, Federata e Atletikës me 64.28 pikë, Federata e Sportit Shkollor me 58.55 pikë, Federata e Pingpongut me 58.10 pikë, Federata e Notit me 57.99 dhe Federata e Tenisit me 50.00 pikë. Në kategorinë C bëjnë pjesë: Federata e Çiklizmit me 40,10 pikë, Federata e Sportit Universitar me 39.04 pikë,

Federata e Bodybuildingut me 38.91 pikë, Federata e Peshëngritjes me 35.96 pikë, Federata e Bowlingut e Kosovës me 35.42 pikë, Federata e Autosporteve me 34.79 pikë si dhe Federata Aeronautike e Kosovës me 30.77 pikë. Ndërsa në kategorinë e fundit, atë D janë kategorizuar këto federata: Federata e Kikboksit e Kosovës me 28.23 pikë, Federata e Muaythait e Kosovës me 25.28 pikë, Federata e Bilardos e Kosovës me 22.65 pikë si dhe Federata Sportive e Punëtorëve me 20.28 pikë. Në kategorizimin e sportistëve kryeson xhudistja Majlinda Kelmendi e pasuar nga tri xhudistet e tjera, Distria Krasniqi, Loriana Kuka dhe Nora Gjakova. Gjithashtu, te trajnerët prin trajneri i mirënjohur Driton Kuka me 212 pikë, pas tij vijnë Besim Brahimi nga sporti i boksit dhe Shqipe Zogiani nga sporti i karatesë. Kujtojmë që Federata e Golfit dhe Minigolfit nuk janë kategorizuar pasi nuk kanë plotësuar kriteret, ndërsa ajo e Bjeshkatërisë nuk ka aplikuar.

Houstoni bie ndaj Portlandit

HOUSTON, 30 JANAR - U luajtën gjashtë ndeshjet e radhës në NBA e sigurisht sfida që tërhiqte vëmendjen kryesore ishte ajo mes Houston Rocketsit dhe Portland Trail Blazersit, e fituar nga ky i fundit me rezultatin 112-125. Duel i pazakontë brenda sfidës mes Russell Westbrookut dhe Damian Lillardit. I pari shënoi 39 pikë e kontrolloi 10 topa, por ai që festoi në fund ishte "ylli" i Blazersit, autor i një "triple double": 36 pikë, 10 "rebounds" e 11 asistime. U nevojiti koha shtesë për ta përcaktuar fituesin në përballjen mes Indiana Pacers dhe Chicago Bulls. Në "Life Fieldhouse" të Indianapolisit festuan vendasit me rezultatin 115-106. Paraqitje e mirë e Victor Oladipos, që kthehej mbi parket pas thuasje një viti në



REZULTATET	
CHICAGO BULLS - INDIANA PACERS	106-115
DETROIT PISTONS - BROOKLYN NETS	115-125
MEMPHIS GRIZZLIES - NEW YORK KNICKS	127-106
UTAH JAZZ - SAN ANTONIO SPURS	120-127
HOUSTON ROCKETS - PORTLAND TRAIL BLAZERS	112-125
OKLAHOMA CITY THUNDER - SACRAMENTO KINGS	120-100

radhët e Pacersit. Ndërkohë Kyrie Irvingu fitoi duelin me Derrick Rose, duke ndihmuar Brooklyn Netsin të triumfoje 125-115 ndaj Detroit Pistonsit. 20 pikë, 5

"rebounds" e 5 asiste ishin statistikat e ish-basketbollistit të Cavsit dhe Celticsit. Sa iu përket pikëve më mirë rezultoi Dinwiddie me 28 pikë. Memphis Grizzlies dominoi ndaj New York Knicksit me rezultatin 127-106, me një tjetër paraqitje mbresëlënëse të "rookie"-t Ja Morant, që shënoi 18 pikë dhe dha 10 asistime. 120-100 triumfoi Oklahoma City Thunderi në parketin e Sacramento Kingsit, ku spikati Schroederi me 24 pikë e 9 asiste, ndërsa Dort shtoi edhe 23 pikë të tjera për teksanët. Surprizon Utah Jazz, që nuk e konfirmoi formën e mirë përballë skuadrës së San Antonios më të dobët të 23 vjetëve të fundit, duke humbur 127-120 në "AT&T Center", ku skenën e rrëmbeu DeMar DeRozan me plot 38 pikë.

SHKURT

Lladrovci, lojtar i ri i Drenasit

Futbollisti Drilon Lladrovci ka nënshkruar për skuadrën e Drenasit, e cila bën pjesë në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. "Falënderoj kryesinë për besimin e dhënë si dhe bashkëlojtarët për mikpritjen. Ndihem i lumtur që më është dhënë mundësia ta përfaqësoj klubin nga qyteti im, Drenasi, dhe premtoj se do ta jap maksimumin që t'i përmbushim objektivat e klubit. Përpara Drenas!", ka shkruar Lladrovci në profilin e vet në "Facebook". Lladrovci në sezonin vjeshtor ishte pjesë e Drenicës në Superligë, kurse më herët ka mbrojtur ngjyrat e Feronikelit dhe Flamurtarit.

Piateku kryen testet mjekësore te Hertha

Krzysztof Piatek do t'i bashkohet Hertha Berlinit për një shifër prej 27 milionë eurosh. Polaku pas hapësirave të vogla në klubin e Milanit vendosi të transferohet në Gjermani ku ka kryer edhe testet mjekësore. Piateku në klubin nga kryeqyteti gjerman do të përfitojë dy miliona euro më shumë sesa fitonte te Milani. 24-vjeçari ka luajtur edhe për Lechia Dzierzoniow, Zagłębie Lubin, Cracovia dhe Genoan.

Thyen heshtjen bashkëshortja e Kobe Bryantit

Bashkëshortja e Kobe Bryantit, Vanessa, e theu heshtjen përmes një postimi prekës në "Instagram", ku flet për vdekjen e bashkëshortit të saj dhe vajzës 13-vjeçare Gianna Bryant. Ylli i basketbollit 41-vjeçar dhe vajza e tij vdiqën të dielën, pasi helikopteri me të cilin po udhëtonin bashkë me shtatë persona të tjerë u rrëzua në Los Anxhelos. Vanessa Bryant ka thënë se ajo dhe tri vajzat e tjera të saj me Koben kanë qenë të shkatërruara nga kjo ngjarje. "Vajzat e mia dhe unë duam t'i falënderojmë miliona njerëzit që kanë treguar mbështetje dhe dashuri gjatë kësaj periudhe të tmerrshme. Faleminderit për të gjitha lutjet. Pa dyshim se kemi nevojë për to", ka shkruar Vanessa. "Jemi plotësisht të shkatërruara nga humbja e papritur e burrit tim të adhuruar, Kobe - babai i mrekullueshëm i fëmijëve tonë; dhe Giannan time të bukur e të ëmbël - një vajzë e dashur, e mrekullueshme dhe e kujdesshme, si dhe një motër e mrekullueshme për Natalian, Biankan dhe Caprin". "Ne jemi të shkatërruara edhe për familjet që i humbën të afërmit e tyre të dielën dhe e ndajmë në mënyrë intime dhimbjen me ta. Nuk ka mjaftueshëm fjalë për ta përshkruar dhimbjen tonë tani. Unë gjej ngushëllim te fakti se Kobe dhe Gigin e dinin të dy se sa shumë i donin njerëzit. Ne ishim jashtëzakonisht të bekuar që i kishim ata në jetën tonë. Do ta doja t'i kishim me vete përgjithmonë. Ata ishin bekimi ynë i bukur, që na u mor shumë shpejt", ka shtuar ajo. "Nuk jam e sigurt se çfarë do të bëhet me jetën tonë përtej të sotshmes dhe është e pamundur ta imagjinoj jetën pa ta. Por, ne zgjohemi çdo ditë, duke tentuar të vazhdojmë përpara sepse Kobe dhe vajza jonë Gigi janë duke na e ndriçuar rrugën. Dashuria jonë për ta është e pafund dhe e pamatshme. Unë thjesht dëshiroj të kisha mundësi t'i përqafoja, t'i puthja dhe t'i bekoja. T'i kem ata këtu me ne, përgjithmonë". "Faleminderit që e keni ndarë gëzimin tuaj, mërzinë tuaj dhe mbështetjen tuaj me ne! Ju kërkohet që të na i jepni respektin dhe privatësinë që na duhet për ta gjetur rrugën tonë në këtë realitet të ri. Për ta nderuar familjen Team Mamba, fondacioni Mamba Sports e ka nisur fondin MambaOnThree për t'u ndihmuar familjeve të tjera të prekura nga kjo tragjedi. Për të dhuruar, ju lutem shkoni te MambaOnThree.org. Faleminderit shumë që na keni mbajtur në lutjet e juaja dhe që na keni shprehur dashurinë mua, kobe, Natalias, Gigit, Biankas dhe Caprit".



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, kompania “PremiumBau” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të asfaltit në Llapllasellë komuna e Graçanicës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 27.02.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant pizzeria “Hib Petrol” tek rrethi i QMI-së në anën e djathtë të rrugës Lipjan-Prishtinë, do të organizohet debat publik nga kompania “PremiumBau” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të asfaltit në Llapllasellë komuna e Graçanicës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “LELA-LOREAL” SH.P.K. me seli në Breznic Obiliq, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 810167173, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “LELA-LOREAL” D.O.O. Breznic Obiliq, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : 810167173, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “LELA-LOREAL” L.L.C, Breznic Obiliq, has come to the decision to quit its business: 810167173 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Kërkoj kujdestare për vajzën 7 muajshe në Prishtinë. Për informata në tel: 044-444-009


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 ☎ +386 49 848 553


PRISHTINË


 **Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





 www.facebook.com/gjejpuneshpeite


Lume's Details


Estetik & Depilim






 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Infrastruktura Hekurdhave të Kosovës "INFRAKOS" Sh.A publikon:

VAZHDIM KONKURSI

Duke u bazuar në vendimin e Menaxhmentit, Infracos Sh.A njofton të gjithë të interesuarit se vazhdohet konkursi nr. 22/2 për vendet e punës

- Drejtues i lëvizjes së trenave praktikant,
- Ndërrues i binarëve praktikant,
- Zyrtar ligjor dhe
- Ekonomist i diplom. praktikant

Vazhdimi bëhet edhe për shtatë (7) ditë kalendarike duke filluar nga data e publikimit në mjetet e informimit publik gjegjësisht deri më 06/02/2020 në ora 16.00 min.

Konkursi bazë ka qenë i publikuar në të përditshmen Epoka e Re të datës 16/01/2020.

Arsyeja e vazhdimit të konkursit është ofrimi i mundësisë që sa më shumë kandidatët të gjinive dhe nacionaliteteve të ndryshme të aplikojnë për punë në Infracos Sh.A.

Për informata të tjera na kontaktoni në numrin e tel. 038 550 550 237.



Infrastruktura Kaosovskih zeleznica "INFRAKOS" DD objavljuje:

KONKURS

Radno mesto : OTPRAVNIK VOZOVA – Pripravnik(6 radnih mesta)

Departament : Odsek za zeleznicki saobraćaj

UGOVOR : Na odredjeno vreme

Radi pod nadzorom Sefa stanice

OPIS POSLOVA

- Za vreme izvršenja pripravnickog stazha kandidat treba da se pridržava svih poslova i radnih obaveza koje pripadaju Otpravniku vozova, predviđene po Pravilniku za sistematizaciju i opis radnih zadataka, Pravilniku za radne odnose i drugih Pravilnika koji se primenjuju na Kosovskim zeleznicama – Infracos DD.

USLOVI, ZA KONKURISANJE I ZNANJE KOJE SE TRAZI

- Saobraćajno transportni tehnicar
- Sposoban za resavanje problema
- Da poseduje organizacione sposobnosti, sposobost za inicijativu i za timsko planiranje
- Da poseduje prvu zdravstvenu grupu
- Da poznaje dobro albanski i srpski jezik. Pozeljno englezki
- Da poznaje rad na kompjuteru

Radno mesto : SKRETNICAR – Pripravnik(6 radnih mesta)

Departament : Odsek za zeleznicki saobraćaj

UGOVOR : Na odredjeno vreme

Radi pod nadzorom Otpravnika vozova

OPIS POSLOVA

- Za vreme izvršenja pripravnickog stazha kandidat treba da se pridržava svih poslova i radnih obaveza koje pripadaju Skretnicara, predviđene po Pravilniku za sistematizaciju i opis radnih zadataka, Pravilniku za radne odnose i drugih Pravilnika koji se primenjuju na Kosovskim zeleznicama – Infracos DD.

USLOVI, ZA KONKURISANJE I ZNANJE KOJE SE TRAZI

- Srednja skola
- Dobro zdravstveno stanje
- Da poznaje dobro albanski i srpski jezik.

POZITA: Pravni zastupnik

NJESIA: Odsek za pravne poslove

KONTRATA: Na neodredjeno vreme

Podnosi izvestaj: Nadzorniku odseka za pravne poslove

OPIS POSLOVA:

- Prisustvuje izradi Pravilnika, uputstava i drugih pravnih akata vezane za Kompaniju
- Zastupa Kompaniju pred sudovima na celoj teritoriji Rep. Kosove
- Iniciranje i pokretanje pravnih postupaka pred odgovarajucim sudovima
- Pokretanje tuzbi, zalbe i drugih postupaka pred sudom
- Po zahtevu nadzornika pravnog odseka izvrsava i drugih radnih poslova

USLOVI, ZA KONKURISANJE I ZNANJE KOJE SE TRAZI

- Diplomirani pravnik
- Pozeljan pravosudni ispit
- Minimum dve godine radnog staza u profesiji
- Da je upoznat sa zakonima i da redovno prati izmene i dopune istih
- Da poseduje sposobnost za rad u posebnim okolnostima i za završavanje zadataka na vreme
- Da poznaje rad na kompjutu MS Windows dhe MS Office
- Komunikativna sposobnost
- Da poznaje dobro albanski i srpski jezik. Pozeljno englezki

Radno mesto : Diplomirani ekonomista – Pripravnik(1 radno mesto)

Departament : Neodredjen

UGOVOR : Na odredjeno vreme

OPIS POSLOVA:

- Za vreme izvršenja pripravnickog stazha kandidat treba da se pridržava svih poslova i radnih obaveza koje pripadaju Diplomiranog ekonomista, predviđene po Pravilniku za sistematizaciju i opis radnih zadataka, Pravilniku za radne odnose i drugih Pravilnika koji se primenjuju na Kosovskim zeleznicama – Infracos DD.

USLOVI, ZA KONKURISANJE I ZNANJE KOJE SE TRAZI:

- Diplomirani ekonomista
- Odlicne organizacione sposobnosti
- Komunikativna sposobnost
- Da poznaje rad na kompjutu MS Windows dhe MS Office
- Da poznaje dobro albanski i srpski jezik. Pozeljno englezki

PROCEDURA ZA KONKURISANJE:

Aplikacije se uzimaju u zgradi direkcije Infracosa DD u Kosovo Polje adresa: Sheshi i Lirisë bb.

Dokumenta je potrebno predati u zatvorenoj koverti na kojoj je potrebno navesti ime i prezime i poziciju za koju konkurisete.

Poslednji datum za konkurisanje je 06/02/2020 u 16.00 h.

Nepotpuna dokumenta i dokumenta prispela posle roka nece se uzimati u razmatranje. Priljena dokumenta se ne vraćaju. Za sve ostale informacije mozete nas kontaktirati na broj tel. 038 550 550 237.

Kompania "EURO-VETFARM" SH.P.K merr vendim që më 31.01.2020 të bëjë shpalljen e likuidimit të kompanisë me numër të biznesit: 70348942 dhe me numër fiskal: 600055794.

Kompanija "EURO-VETFARM" SH.P.K 31.01.2020 odluci da objavi likvidacija broj preduzeca kompanije: 70348942 i fiskalni broj: 600055794.

The company "EURO-VETFARM" SH.P.K takes the decision announcing the liquidation of the company with business number: 70348942 and fiscal number: 600055794 on 31.01.2020.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Superprona O.P.", shpallë të humbur dhe të pavlefshme çertifikatën e vjetër të biznesit me numër biznesi 70886510.

► SH.P.K "Enisi Group" shpall të pavlefshme çertifikatën e TVSH-së, me numër 330405995, Vushtrri

► "Lux Dentima", SH.P.K. me numër të biznesit 810190249 me adresë në Prishtinë, Rr, Elbasanit p.n i njofton të gjithë debitorët dhe kreditorë se ka marre vendim për zvogëlimin e kapitalit themelor, zvogëlimi i kapitalit themelor do të bëhet nga shuma fillestare 50000 (pesëdhjetë mijë) në 5000 Euro.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistranja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.
Tel. 044-413-197.